REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DIBËR**
**DREJTORIA EKONOMIKE**
**Sektori i Financës**

# PROJEKT- V E N D I M
**Nr. 05 Datë 23/06/2025**

**"Për miratimin e shpenzimeve per Investime per projektin Rikonstruksion i ambjenteve të shkolles 9 –vjecare Nazmi Rushiti,Dovolan".**

Në mbështetje të ligjit 139/2015"Për veteqeverisjen vendore" në mbështetje të ligjit nr.9936,date 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise e vitit 2025",udhezim nr.9 date 20.03.2018 "Per procedurat standarde te zbatimit te buxhetit " te ndryshuar, ne vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr. 5, datë 15.01.2025, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin, nr.31/1 prot. datë 20.01.2025 i ndryshuar,shkresen nr 2174/1 prot date 02.04.2025 te Ministrise te Arsimit dhe Sportit protokolluar ne Bashki me nr 141 date 15.04.2025 ,urdhrin nr 132 02.04.2025 per financimin e projekteve te reja per infrastrukturen shkollore dhe sportive

**Kërkojmë:**

I. Miratimin e investimit nga prokurimi i objektit: "Rikonstruksion i ambjenteve të shkolles 9 –vjecare Nazmi Rushiti,Dovolan" me vlerë 22,852,603 lekë për financimin e objektit : "Shkolla 9-vjecare Nazmi Rushiti ,Dovolan"me kod projekti 22AC530.

**Të . Shtohet**

| Grupi | Kapitulli | Programi | Artikulli | Kod projekti | Shuma (leke) |
|---|---|---|---|---|---|
| 11 | 01 | 9120 | 231 | 22AC530 | 3,656,416 - viti 2025 |
| 11 | 01 | 9120 | 231 | 22AC530 | 14,625,666- viti 2026 |
| 0.0 | 01 | 9120 | 231 | 22AC530 | 4,570,521- viti 2026 |

II. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.

III. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR

| Drejtor Ekonomik | Drejtor Juridik | Drejtor Urbanistike | Drejtor I.E.N.H |
|---|---|---|---|
| Çeljeta ZUNA | Ismet Saraci | Elvis Manga | Ridjan Kata |

*Adresa:Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi,nr.tel.& fax. 00355 218 229 37 e-mail: bashkiadiber@gmail.com*

Kryetari
Rahim SPAHIU

Në mungesë dhe me porosi
Nën Kryetari i Bashkisë
Lorenc CIBAKU

*Adresa:Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi,nr.tel.& fax. 00355 218 229 37 e-mail: bashkiadiber@gmail.com*

1611
15/04/25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 1341/14 Prot. Tiranë, më 15.04.2025

**Lënda:** Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për objekte shkollore të arsimit para universitar dhe programit për sportin.

**BASHKISË** Dibër

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, të nenit 15, ligjit nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", urdhrit nr. 60, datë 07.02.2025, të ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për shpërndarjen e financimit për projekte nga programet "Arsimi Bazë", "Arsimi i Mesëm" dhe programi "Për Zhvillimin e Sportit", për infrastrukturën shkollore e sportive, me cikël financimi 2025-2026", ju bëjmë me dije se jeni shpallur fitues për projektin/projektet sipas urdhrit bashkëlidhur.

Referuar legjislacionit të sipërcituar, në mbështetje të:

1. Ligjit nr. 107/2014 datë 31.07.2014, i ndryshuar, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".
2. Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin e disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar.
3. Vendimit nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje, kolaudim".
4. Vendimit nr. 319, datë 12.04.2017, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave", i ndryshuar.
5. Vendimit nr.216, datë 13.04.2023, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim".
6. Vendimit nr.537, datë 08.07.2020 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe elementeve të ndërtesave".
7. Vendimit nr.26, datë 15.01.2020, të Këshillit të Ministrave "Për kryerjen e akt-ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara".
8. Vendimit nr.887, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike", i ndryshuar, njësia e vetëqeverisjes vendore, të marrë masat për realizimin e procedurave të prokurimit konform legjislacionit në fuqi dhe angazhimin e pjesës takuese të bashkëfinancimit, duke obliguar fondet përkatëse në sistemin e thesarit, në masën jo më pak se 20% për vitin 2025, të pjesës takuese të bashkëfinancimit të NJQV-së. Pas realizimit të procedurave të prokurimit, një kopje e kontratës së nënshkruar duhet të përcillet zyrtarisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**ZËVENDËSMINISTRI**

**Orjana OSMANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 179 Prot. Datë 2. 4. 2025

**URDHËR**

**Nr. 12, datë 2.04.2025**

**PËR**

**PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR PROJEKTE TË REJA, ME CIKËL FINANCIMI 2025-2026, NGA PROGRAMET "ARSIMI BAZË", "ARSIMI I MESËM" DHE PROGRAMI "PËR SPORTIN", PËR INFRASTRUKTURËN SHKOLLORE E SPORTIVE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 15, pika 11, të ligjit nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", Udhëzimit nr. 9, datë 27.04.2022 "Për kriteret, procedurat dhe afatet për shpalljen e thirrjes dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin/bashkëfinancimin e projekteve për përmirësimin e të infrastrukturës shkollore dhe sportive", si dhe Urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani".

**URDHËROJ :**

1. Miratimin e projekteve të reja, me cikël financimi 2025-2026, thirrja e parë, të cilat financohen nga programet buxhetore "Arsimi bazë", "Arsimi i mesëm" dhe programi "Për Sportin".
2. Masa e financimit nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për arsimin, për periudhën afatmesme 2025-2027, si dhe pjesa takuese e bashkëfinancimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, është sipas tabelës bashkëlidhur.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, projektet e të cilëve janë shpallur fituese, njoftohen zyrtarisht për marrjen e masave për realizimin e procedurave të prokurimit dhe angazhimin në buxhetin e vitit 2025 të pjesës takuese të bashkëfinancimit
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSMINISTËR**

**Orjana Osmani**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT TIRANË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

Tabela nr. 1 _ Rishpërndarje e fondeve buxhetore kapitale për vitin 2025-2027

Në lekë

| Entiteti i Qeverisjes | Ministria e Linjes | Kodi Institucionit | Emer institucioni | Kapitulli | Programi | Llogaria Ekonomike | Kodi i Deges se Thesarit | KOD Produkti | Emertimi i produktit | Buxheti 2025 | Buxheti 2026 | Buxheti 2027 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shtohet | | | | | | | | | | 3,656,416 | 14,625,666 | - |
| 106 | 11 | 2106001 | Bashkia Dibër | 01 | 09120 | 2310000 | 0606 | 22AC530 | Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Nazmi Rushiti", Dovolan_Bashkia Dibër | 3,656,416 | 14,625,666 | |
| | | | | | Totali Shtesave | | | | | 3,656,416 | 14,625,666 | 0 |

Tabela 1. Lista e projekteve me cikël financimi për periudhën afatmesme 2025-2027

| Nr | NJQV | Emërtimi i Projektit | Vlera e plotë e projekit | Kontributi në financim nga NJQV | Financimi ne lekë (Viti 2025) MAS+NJQV | Financimi i MAS per vitin 2025 | Financimi ne lel (viti 2026-2027 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Dibër | Rikonstruksion i shkolles 9-vjeçare "Nazmi Rushiti", Dovolan | 22,852,603 | **4,570,521** | 4,570,521 | 3,656,416 | 13,711,562 |

2024 04/06/25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 3485/1 Prot. Tiranë, më 28.05.2025

**Lënda:** Dërgohen shkresa nr.8255/1, datë 27.05.2025 "Transferim fondi për shpenzime kapitale"

**BASHKISË** Dibra

**INSTITUCIONIT** ________________

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr.115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, udhëzimin plotësues nr.2, datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", bashkëlidhur ju dërgojmë shkresën nr.8255/1, datë 27.05.2025, të Ministrisë së Financave "Transferim fondi për shpenzime kapitale me shpërndarjen e fondeve të buxhetit të miratuar në grupin e shpenzimeve kapitale, për vitet 2025-2027, për çdo njësi shpenzuese, sipas klasifikimit buxhetor, në nivel artikulli dhe produkti të miratuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT - TIRANË

**Erzen Tola**

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 23, AL 1001, Tiranë

Web site: www.arsimi.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 8255/ 1 prot. Tiranë, më __.__.2025

Lënda: Transferim fondi për shpenzimet kapitale.

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT
Tiranë
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË THESARIT
Tiranë
DEGËS SË THESARIT TIRANË
Tiranë
DEGËS SË THESARIT ______________

Në zbatim të ligjit nr. 115/2024 "*Për buxhetin e vitit 2025*", të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit*", të Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 24.01.2025 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025*", si dhe në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me nr. 3183 prot., datë 21.05.2025, miratojmë transferimin e fondeve për shpenzimet kapitale, sipas tabelës bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

MINISTRI

Petrit Malaj

Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Nr. 3, Tiranë, Shqipëri; Web: www.financa.gov.al

**RELACION**

Në mbështetje të ligjit 139/2015"Për veteqeverisjen vendore" në mbështetje të ligjit nr.9936,date 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise e vitit 2025",udhezim nr.9 date 20.03.2018 "Per procedurat standarde te zbatimit te buxhetit " te ndryshuar, ne vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr. 5, datë 15.01.2025, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin, nr.31/1 prot. datë 20.01.2025 i ndryshuar,shkresen nr 2174/1 prot date 02.04.2025 te Ministrise te Arsimit dhe Sportit protokolluar ne Bashki me nr 141 date 15.04.2025 ,urdhrin nr 132 02.04.2025 për financimin e projekteve të reja për infrastrukturën shkollore dhe sportive për Bashkinë Dibër u miratua projekti "Për Rikonstruksion ambjentesh të shkollës 9-vjecare Dovolan" në vlerën 22,852,603 me kod projekti 22AC530 me bashkëfinancim ndërmjet Bashkisë Dibër dhe Ministrisë Arsimit dhe Sportit

Vlera e financimit nga MAS në masën 80% - 18,282,082 financim viti 2025-2026
Vlera e financimit nga Bashkia Dibër në masën 20% - 4,570,521 financim viti 2026

**Drejtor I.E.N.H**
**Ridjan Kata**

**Drejtor Ekonomik**
**Çeljeta Zuna**

**MIRATOI:**
**KRYETARI I BASHKISE DIBER**
Rahim SPAHIU

# PREVENTIV

**Objekti :** **RIKONSTRUKSION I SHKOLLËS 9 - VJEÇARE DOVOLAN**

**Vendi i ndërtimit :** **PESHKOPI , DIBËR**

| NR. | PËRSHKRIMI I PUNIMEVE | NJËSIA | SHUMA |
|---|---|---|---|
| 1 | Punime ndërtimi | lekë | 12,880,409.66 |
| 2 | Punime mekanike | lekë | 2,113,088.82 |
| 3 | Punime elektrike | lekë | 1,466,383.37 |
| 4 | SHUMA | lekë | 16,459,881.84 |
| 5 | FONDI REZERVË 5% | lekë | 822,994.09 |
| 6 | SHUMA | lekë | 17,282,875.94 |
| 7 | T.V.SH.20% | lekë | 3,456,575.19 |
| 8 | SHUMA | lekë | 20,739,451.12 |
| 9 | PAISJET ME T.V.SH (mekanik + elektrik) | lekë | 2,113,152.00 |
| 10 | Shuma | lekë | 22,852,603.12 |

| | | |
|---|---|---|
| *Tarifa për mbikqyrësin e punimeve pa TVSH* | lekë | 290,503.90 |
| *Tarifa për kolaudim punimesh pa TVSH* | lekë | 28,113.28 |

**SHËNIM :**

*Ky preventiv është punuar sipas çmimeve të manualeve të VKM nr.629 datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre". Tarifat për drejtim punimesh dhe kolaudim janë llogaritur sipas VKM Nr.704 datë 29/10/2014 për "Miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikimin Territori, Projektim, Mbikqyerje dhe Kolaudim" dhe VKM Nr.888 datë 17.12.2014 "Disa shtesa dhe ndryshime të VKM Nr.704 datë 29.10.2014 të KM . . ." .*
*Ky preventiv ka dhjetë fletë.*

## SHËNIME TEKNIKE

**Jepet per rikonstruksion shkolla 9-vjecare " Nazmi Rushiti" në fshatin Dovolan, Dibër:**

***Punimet e prishjes :*** **(Perpara punimeve te ndertimit )**

- Prishje muri me tulle te plote t= 30cm ( te specifikuara ne projektin arkitektonik)
- Prishje muri me blloqe betoni t= 25cm
- Prishje te suvatimeve te brendshme te mureve (ne masen 70%) kolonave dhe tavaneve
- Heqje e pllakave prej betoni (25x25cm) ekzistuese te dyshemese dhe shtreses llac cimento te ambjenteve te brendshme dhe hyrjes.
- Heqje e te gjitha dyerve dhe dritareve ekzistuese
- Cmontimi i pjesshem i catise
- Heqje e ullukeve llamarine ne cati
- Te behet cmontimi i kangjellave ne murin rrethues aty ku ka te tilla.

***Punimet e ndertimit :***

### MURET E REJA
- Mure te reja ndarese t= 12cm ( ne zonen e nyjes higjeno- sanitare)
- Mure gipsi kundra lageshtires per zonen e tualeteve t= 5cm
- Mure per mbushje / Mure tulle 30cm
- Mure tulle 25cm

### SHTRESAT
- Një shtresë niveluese me llustër cimento me t= 2 cm.
- Pllakë gres cilesia e pare për dyshemenë
- Te vendosen pilntusa te llojit gres- porcelanat
- Ne ambjentet shtese qe i jane bashkangjitur godines ekzistuese, shtresat e dyshemese do te jene:
  - 20 cm zhavorr
  - 10 cm beton M=150cm
  - 2cm cimento
  - pllaka gres- cilesia e pare

(Për përcaktimin e tonalitetit dhe dimensionit të pllakës të kontaktohet autori i projektit )

### MURET DHE TAVANET
- Të bëhet suvatimi i mureve brenda dhe jashte dhe i tavaneve ne masen 100%.
- Nen tavanin ekzistues do vihet tavan i varur me kartonxhes i perbere nga keto shtresa:
  1. Pllake gipsi 1cm
  2. Lesh guri 5cm
  3. Pllake gipsi 1cm
- Tavani i varur me kartonxhes të patinohet dhe te lyhet.
- Muret e brendeshme dhe te jashtme si dhe tavani do të lyhen me bojë hidroplastike me ngjyra sipas projektit arkitektonik ( per zgjedhjen e kodeve te ngjyrave te kontaktohet autori i projektit).
- Muret e reja ne zonen e tualeteve te jene me knauf t=10cm me dy shtresa kunder lageshtires.

### DYER- DRITARE
- Dyert dhe dritaret të vendosen të reja sipas tabelës dyer - dritare.
- Te vendosen davancale mermeri t= 3 cm ne cdo dritare
- Perpara prodhimit te dyer dhe dritareve te reja te konfirmohen matjet ne vend .

### PAJISJET H/SANITARE
- Do të vendosen të reja

### FASADA:
- Te behet riparimi i rifinitures ne masen 100% si dhe te respektohet zgjidhja e ngjyrave ne te sipas projektit.

### ÇATIA:
- Te behet riparimi i catise aty ku ka demtime
- Shkarrkimi i ujrave te shiut te behet nepermjet ullukut horizontal PVC ne 3 tuba PVC Ø= 120mm

### SISTEMIMI:
- Te behet shtrimi i trotuarit pergjat perimetrit te godines dhe zones brenda rrethimit te shkolles duke perdorur pllaka betoni 6cm mbi rene dhe bodure (12x25cm)
- Te behet sistemimi i shesheve sipas zonimit funksional te paraqitur ne projekt. (Fusha sportive, zona me rere, pasazhet e kalimit te shtruara me dru apostafat, parcelat e gjeberuara dhe te mbjella me lule)

### MBI SISTEMIN E NGROHJES TE SHKOLLES

Ngrohja gjate periudhes se dimrit ne mjediset e shkolles se fshatit Dovolan, rrethi i Dibres, do te realizohet nepermjet nje sistemi me kaldaje, me ane te qarkullimit te ujit nelinjat e tubacioneve qe perfundojne ne kembyesit e nxehtesise te tipit radiatore. Sistemi do te kete valvol sigurie dhe ene zgjerimi.

Nuk do te kete rregullim automatik.

Kaldaja do te jete me fuqi nominale 100 kW, ne gjendje te perdore si lëndë djegëse biomasë (dru, pelet, dhe qymyr i briketuar).

Kaldaja do te kete:

·Panel kontrolli e ndezje automatike të peletit me rezistencë elektrike.

·Do të ketë opsionin e ndërprerjes automatike të dërgimit të peletit dhe vazhdimin e djegies së lëndës drusore kur fuqia e zhvilluar nga peleti arrin vleren nominale të regjistruar.

·Furnizimi i furres do të jetë biaksial, pra me dispozitiv sigurie për ndalimin e kthimit të flakës në drejtim të depozitës së peletit.

·Do të ketë dritare të mbyllur me fllanxhë, që mund të përdoret si zgjidhje emergjence për montimin e një djegësi me naftë ose gaz GPL.

·Të jetë e testuar dhe e çertifikuar sipas Standardit EN 303-5.

Nuk jane parashikuar kaldaja rezerve.

Linjat e qarkullimit te ujit te behen me tub çeliku 3”, seri e rende dhe te lyhen me dy duar boje minio.

Qarkullimi i ujit i detyruar, me pompe qarkullimi per uje te ngrohte sanitar ne sistemet ngrohese, me parametrat teknike:

- Presioni maksimal 10 bar;
- Prurja deri ne 19 m³/h;
- Lartesia H deri 12 m;

Ngrohja në klasa realizohet nëpërmjet radiatorëve, te cilet do te kene fuqi termike 600 W dhe 800 W.

- Ç'do kat do pajiset me të paktën tre fikëse zjarri.

### TABELA DRITARE - DYER

| Nr | Tipi | Masat(cm) | Cope | Pershkrimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | $D_1$ | 130x 155 | 23 | Dritare duralumini dopjo xham |
| 2 | $D_2$ | 115 x 155 | 11 | Dritare duralumini dopjo xham |
| 3 | $D_3$ | 130 x 90 | 1 | Dritare duralumini dopjo xham |
| 4 | $D_4$ | 120 x 155 | 1 | Dritare duralumini dopjo xham |
| 5 | $D_5$ | 60 x 155 | 1 | Dritare duralumini dopjo xham |
| 6 | $D_6$ | 80 x 155 | 1 | Dritare duralumini dopjo xham |
| 7 | $D_7$ | 60 x 70 | 3 | Dritare duralumini dopjo xham |
| 8 | $P_{kaldaja}$ | 160 x 220 | 1 | Dere e blinduar importi |
| 9 | $P_1$ | 160 x 250 | 1 | Dere druri zemer derrase |
| 10 | $P_2$ | 85 x 205 | 11 | Dere druri zemer derrase, $\frac{1}{2}$ xham |
| 11 | $P_3$ | 100 x 205 | 2 | Dere druri zemer derrase, $\frac{1}{2}$ xham |
| 12 | $P_4$ | 70 x 210 | 6 | Dere d/alumini me mbushje |
| 13 | $P_5$ | 95 x 210 | 1 | Dere d/alumini me mbushje |
| 14 | $P_6$ | 80 x 210 | 1 | Dere d/alumini me mbushje |

SHENIM :

- Te gjitha permasat e dyerve dhe dritareve te reja, te verifikohen ne objekt perpara prodhimit te tyre.
- Per tonalitetet e dyerve, dritareve, davancaleve, pllakave dhe ngjyres se bojes se murit e tavaneve te kontaktohet autori.
- Per cdo paqartesi apo problematike te kontaktohet autori.

| RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLËS "DOVOLAN" | PROJEKTI ARKITEKTONIK | A - 01 |
|---|---|---|




**MIRATOI:**
**KRYETARI I BASHKISE DIBER**
**Muharem RAMA**

| RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLËS "DOVOLAN" | PROJEKTI ARKITEKTONIK | A - 02 |
| --- | --- | --- |

Gjendja Ekzistuese
( Plani i Teknik) SH.1:100




Mure qe prishen

Mure qe ndertohen

## Gjendja e Rikonstruktuar
( plani i mobilimit) SH.1:100



Gjendja e Rikonstruktuar
( Plani i Teknik) SH.1:100




Mur i ri

## Prerja A-A




## Prerja B-B



Fasada e rikonstruktuar

Veri- lindje




Veri- perendim



**D2**
Sh. 1:50

DETAJI I NYJES HIGJENO- SANITARE




**D1**
Sh. 1:25

PORTA HYRËSE
(PAMJE GJATËSORE)




**D1**
Sh. 1:25

KANGJELLA
55ml

(PAMJE GJATËSORE)

(PRERJE TËRTHORE A-A)




TABELA E PROFILEVE METALIK TË PORTËS HYRËSE

| Nr. | Emërtimi | kg/ml | L(m) | kg |
|---|---|---|---|---|
| 1 | RHS 60x20x3mm | 3.41 | 23 | 79 |
| 2 | SHS 80x80x5mm | 11.6 | 17 | 198 |
| | TOTAL | | | 277 kg |

TABELA E PROFILEVE METALIK TË KANGJELLAVE

| Nr. | Emërtimi | L (cm) | Sasia (copë) | kg/ml | kg/2.5ml | kg/L.total (110ml) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | SHS 60x60x3 | 165 | 1 | 5.29 | 8.73 | 384.12 |
| 2 | RHS 20x20x3 | 121 | 15 | 1.6 | 29.04 | 1277.76 |
| 3 | Shirit Metalik 5x40mm | 138 | 4 | 1.57 | 8.7 | 382.8 |
| | TOTAL | | | | | 2044.67 kg |

TABELA E MATERIALEVE PËR RRETHIMIN

| Nr. | Emërtimi | m³/ml | m³/2.5ml | m³/L.total=110ml |
|---|---|---|---|---|
| 4 | Beton | 0.12 | 0.3 | 13.2 |
| 5 | Butobeton | 0.16 | 0.4 | 17.6 |
| 6 | Çakëll | 0.09 | 0.225 | 9.9 |
| 7 | Gërmim | 0.4 | 1 | 44 |

PLANIMETRIA E GJENDJES EGZISTUESE



PLANIMETRIA E GJENDJES PERFUNDIMTARE



PLANIMETRIA E MUREVE QE PRISHEN DHE MUREVE TE REJA



PLANI I MUREVE, ARKITRAREVE & KOLONÇINAVE



| RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLËS "DOVOLAN" | PROJEKTI KONSTRUKTIV | K - 05 |
|---|---|---|

## PLANI I THEMELEVE TE RINJ




## PRERJA "1-1"




Brezi "BR-1"




## DET. "F-1"




**SHENIME TEKNIKE**:
Ky projekt parashikon shtese ambientesh ne anen perendimore te objektit. Kjo shtese do te realizohet me mure mbajtese 25cm me tulle te plote dhe me kollona perforcuese 30x30cm.Perveç pjeses se re kollonat perforcuese do te vendosen edhe tek nyjet qe lidhen me objektin ekzistues.
Themelet te realizohen me beton te markes C12/15 me permasa 60x120cm me brez 50x15 b/a C16/20 ne koke te tij.
Themeli eshte llogaritur per toke me aftesi mbajtese jo me te vogel se 1.5 kg/cm². Gjeresia e mbeshtetjes se themelit duhet te jete jo me pak se b=60cm dhe duhet te zhytet jo me pak se 120cm nga toka natyrale.
Arkitraret do te realizohen me beton C16/20 kurse kollonat perforcuese dhe traret rinj me beton C20/25.
Hekur per armim duhet te jete FeB44k (ose klase ekuivalente) me Rak>3200kg/m².
Punimet te kryen sipas K.T.Z.

Prerja "2-2"




Brezi antisizmik




Armimi i kolonçinave "K-1"



TRAU T-1/1
(1 copë)




TRAU T-1/2
(1 copë)




TRAU T-1/3
(1 copë)




Prerja1-1/1




Prerja1-1/2




Prerja1-1/3




TRAU T-2
(2 copë)




TRAU T-3
(1 copë)




Prerja2-2




Prerja3-3



## ARKITRAU A85/12
(10 copë)




## ARKITRAU A160/30
(1 copë)




## ARKITRAU A130/30
(2 copë)




## ARKITRAU A60/30
(4 copë)




**MATERIALE**

Hekur Ø8-Ø10=365kg
Hekur ≥Ø12=1475kg
Beton C12/15= 14m³
Beton C16/20= 6.4m³
Beton C16/20= 7m³

MIRATOI:
KRYETARI I BASHKISE DIBER
Rahim SPAHIU

# PREVENTIV

**OBJEKTI :RIKONSTRUKSION I SHKOLLËS 9 - VJEÇARE DOVOLAN**
**EMËRTIMI :DRENAZHIM I JASHTËM**

## B. PUNIME HIDROTEKNIKE

| Nr | Shenja e manualit | Emërtimi i materialit | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlefta |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 3.46/1 | Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krah | m³ | 150.00 | 1,214.00 | 182,100.00 |
| 2 | 2.19 | Hedhje,rrafshim,mbushje dheu me krah | m³ | 44.00 | 215.00 | 9,460.00 |
| 3 | 2.37/5b | Transport materiale ndërtimi, dheu me auto | m³ | 106.00 | 467.00 | 49,502.00 |
| 4 | 2.523/1 | F .V tub i brinjëzuar Dn=200 mm drenazhi | ml | 133.00 | 2,156.00 | 286,748.00 |
| 5 | 3.An/1t | F .V tub i brinjëzuar Dn=315 mm | ml | 29.00 | 1,960.00 | 56,840.00 |
| 6 | An-32 | F.V Gjeotekstil GE-Dren 200 g/m2 | m² | 84.00 | 325.00 | 27,300.00 |
| 7 | An | F.V Cakëll për drenazh 5 - 10 cm | m³ | 64.00 | 1,965.00 | 125,760.00 |
| 8 | An | F.V Cakëll për drenazh 3.2 cm | m³ | 35.00 | 1,135.00 | 39,725.00 |
| 9 | 2.258 | Nënshtresë zhavorri | m³ | 2.10 | 1,355.00 | 2,845.50 |
| 10 | An - 19 | Pusetë shkarkimi 80 x 80, h = 100 cm | copë | 3.00 | 33,554.00 | 100,662.00 |
| 11 | An - 20 | Pusetë shkarkimi 80 x 80, h = 150 cm | copë | 2.00 | 36,573.00 | 73,146.00 |
| 12 | An - 18 | Pusete shkarkimi b/a, 50 x 50 cm, h = 100 cm | copë | 2.00 | 6,032.00 | 12,064.00 |
| 13 | 2.261 | F.V Shtresë rëre rreth tubit | m³ | 7.00 | 1,459.00 | 10,213.00 |
| 14 | 2.262/4 | F.V Kanali ekran, beton C 16/20 | m³ | 6.00 | 8,525.00 | 51,150.00 |
| 15 | 2.182 | F.V Konstruksione metalike te thjeshta | kg | 2,060.00 | 135.11 | 278,328.66 |
| | | | | | **SHUMA I** | **1,305,844.16** |

**SHËNIM:**
Çmimet e mësipërme të preventivit janë bazuar tek Manuali 2 e 3 sipas VKM nr.629 datë 15.09.2015 si dhe tek çmimet e dala nga testimi i tregut .

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |

**PREVENTIV**

**OBJEKTI :RIKONSTRUKSION I SHKOLLËS 9 - VJEÇARE DOVOLAN**

**EMËRTIMI : FURNIZIMI ME UJË DHE SHKARKIMI I UJËRAVE TE ZEZA I NYJEVE HIDROSANITARE**

**B. PUNIME HIDROTEKNIKE**

| Nr | Shenja e manualit | Emërtimi i materialit | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlefta |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2.504 | F.V WC alla turka importi | copë | 6.00 | 11,618.00 | 69,708.00 |
| 2 | 2.505 | F.V Pisuar importi porcelani | copë | 3.00 | 8,451.00 | 25,353.00 |
| 3 | 2.495 | F.V Lavaman porcelani importi, drejtkendor, me mishelator | copë | 5.00 | 10,613.00 | 53,065.00 |
| 4 | An | F.V Lavaman porcelani importi, me mishelator per njerez me aftesi te kufizuara | copë | 1.00 | 22,220.00 | 22,220.00 |
| 5 | 2.501 | F.V Wc alla frenga per persona me aftesi te kufizuara | copë | 1.00 | 28,223.00 | 28,223.00 |
| 6 | An | F.V Krah mbajtës fiks per persona me aftesi te kufizuar | copë | 1.00 | 8,470.00 | 8,470.00 |
| 7 | An | F.V kit sanitar me valvul per njerez me aftesi te kufizuara | copë | 1.00 | 10,000.00 | 10,000.00 |
| 8 | 2.An - 16 | F. V bolier 12 liter, uje te ngrohte sanitar | copë | 2.00 | 6,847.00 | 13,694.00 |
| 9 | 2.494/1 | F.V saracineska bronzi Ø 3/4 " = 20 mm | copë | 1.00 | 795.00 | 795.00 |
| 10 | 2.494/2 | F.V saracineska bronzi Ø 1 " = 25 mm | copë | 2.00 | 985.00 | 1,970.00 |
| 11 | 2.494/3 | F.V saracineska bronzi Ø 1 1/4 " = 32 mm | copë | 3.00 | 1,305.00 | 3,915.00 |
| 12 | An | F.V Tub flesibel 1/2", L=500 mm | copë | 13.00 | 339.00 | 4,407.00 |
| 13 | An | F.V Filter saracineske 1/2" | copë | 13.00 | 494.00 | 6,422.00 |
| 14 | 2.535/c | Termoizolim tubi Ø 1" me armofleks (d35x9) | copë | 13.00 | 13,589.00 | 176,657.00 |
| 15 | 2.515 | F.V Pilete dyshemeje d 50 | copë | 1.00 | 1,925.00 | 1,925.00 |
| 16 | An | F.V Tub kanalizimi pvc Ø 50 mm | ml | 17.00 | 911.00 | 15,487.00 |
| 17 | 2.520 | F.V Tub kanalizimi pvc Ø 110 mm | ml | 11.00 | 1,194.00 | 13,134.00 |
| 18 | 2.521 | Tub kanalizimi pvc Ø 140 mm | ml | 10.00 | 1,380.00 | 13,800.00 |
| 19 | 2.516 | Pjese speciale pvc | kg | 7.00 | 552.00 | 3,864.00 |
| 20 | An - 15 | F V bolier 80 liter, uje te ngrohte | copë | 1.00 | 13,589.00 | 13,589.00 |
| 21 | 2.491/b | F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20 mm, PN 16 | ml | 37.00 | 304.00 | 11,248.00 |
| 22 | 2.491/b | F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=25mm, PN 16 | ml | 6.00 | 304.00 | 1,824.00 |
| 23 | 2.491/c | F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=32mm, PN 16 | ml | 13.00 | 330.00 | 4,290.00 |
| 24 | 2.491/c | F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=32mm, t = 2.4 mm, PN 10 | ml | 80.00 | 217.00 | 17,360.00 |
| 25 | 2.491 | F.V tub xingato dhe rakorderi Ø ~ 1 " | kg | 9.78 | 397.00 | 3,882.66 |
| 26 | An | F.V Valvol moskthimi Ø ~ 1 " | copë | 2.00 | 4,272.00 | 8,544.00 |
| 27 | An | F.V Presostat | copë | 1.00 | 5,000.00 | 5,000.00 |
| 28 | 2.262/1 | Shtrese betoni C 7/10 | $m^3$ | 0.50 | 7,994.00 | 3,997.00 |
| 29 | An - 19 | Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 100 cm | copë | 1.00 | 33,554.00 | 33,554.00 |
| 30 | An | Hapje vrimash në themel | copë | 2.00 | 510.00 | 1,020.00 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 31 | 2.15/a | Germim kanalesh në tokë te fortë | m$^3$ | 3.00 | 1,274.00 | 3,822.00 |
| 32 | An | F.V Aksesor (pasqyre) | copë | 3.00 | 4,986.00 | 14,958.00 |
| 33 | An | F.V Krah mbajtës i levizshem per persona me aftesi te kufizuar | copë | 1.00 | 10,377.00 | 10,377.00 |
| 34 | An - 14 | Hidroboks 500 l | copë | 1.00 | 46,200.00 | 46,200.00 |
| 35 | An | Rubinetë 1/2" | copë | 6.00 | 745.00 | 4,470.00 |
| | | | | | **SHUMA II** | **657,244.66** |
| | | | | | | |
| | | | | **SHUMA TOTALE (I + II )** | | **1,963,088.82** |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | **SHËNIM:** | | | | |
| | | Çmimet e mësipërme të preventivit janë bazuar tek Manuali 2 sipas VKM nr.629 | | | | |
| | | datë 15.09.2015 si dhe tek çmimet e dala nga testimi i tregut . | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | **VLERA E PAISJEVE ME TVSH** | | | | |
| 1 | | Pompë zhytëse Q=130 l/min, H=30 m | copë | 1.00 | 35,000.00 | 35,000.00 |
| | | | | | **SHUMA** | **35,000.00** |
| | | **SHËNIM:** | | | | |
| | | Ky preventiv përfshin çmimet e materialeve me TVSH që ndodhen sot në treg | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |

| RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLËS "DOVOLAN" | PROJEKTI ELEKTRIK | E - 01 |
|---|---|---|

# PLANI I SISTEMIT TE NDRICIMIT




## LEGJENDE:

- Ndricues fluoreshent 2x36W, IP40
- Ndriçues tip prozhektor 60 w LED IP 65
- Celes i thjeshte 10A 220V
- Kuti shperndarese B/M PT5
- Kuti shperndarese B/M PT4
- Kuti shperndarese B/M PT8
- Percjelles i veshur me izolim PVC 3(1x1.5mm²) ne tub fleksibel PVC Ø20mm
- Percjelles i veshur me izolim PVC 3(1x2.5mm²) ne tub fleksibel PVC Ø20mm
- Panel plastik B/M 36M
- Panel plastik B/M 24M

# PLANI I SISTEMIT TE FUQISE




Instalimet e fuqise do realizohen me kabell bakri tip FG7 (0)R 0.6/1kV .
Instalimet do te behen me tub rigid jfleksibel seria rende brenda murit sipas specifikimeve ne projekt . Pika e furnizimit te objektit do te merret nga shtylla elektrike qe ndodhet afer objektit sic tregohet ne projekt .Rruga e kalimit te kabullit do te jete ajrore deri te kulmi i catise dhe me pase do te hyje te kuadrin kryesor te objektit.
Objekti do te kete nje kuader elektrik kryesor i cili do te furnizoj edhe kuadrin dytesor "K1 "dhe gjithashtu do te furnizoj me energji dhe zonen e parashikuar ne projekt . Rruga e kalimit te furnizimit te kuadrove sekondare nga kuadri kryesor do te behet me tub korrogato nen toke .
Instalimet e ndriçimit dhe fuqise realizohen me percjellsa N07V-K 3(1x1.5mm²) dhe 3(1x2.5mm²) ne tubo TP Ø20mm seri e lehte dhe TPØ20mm seri e rende ne dysheme.

Linjat e prizave dhe te ushqimit te kuadrove jane me 3 dhe 5 percjellesa,percjellesi i trete dhe i peste sherben per tokezimin mbrojtes.
Kuadri elektrik, prizat e fuqis,çelsat ,kutit shperndarse brenda murit vendosen perkatesisht ne lartesit +1.7ml , +0.4ml, 0.9ml, +0.3ml nga niveli +0.00 i dyshemese.

Te respektohet ndarja e ngarkesave ne faza.

## LEGJENDA:

- Panel plastik B/M 36M
- Panel plastik B/M 24M
- Kuti shperndarese B/M PT 8
- Kuti shperndarese B/M PT 5
- Kuti shperndarese B/M PT 4
- Kuti shperndarese J/M PT 5
- Prize shuko e bardhe 16A, 220V
- P.P
- Percjelles i veshur me izolim PVC 3(1x2.5mm²) ne tub fleksibel Ø20mm
- Percjelles i veshur me izolim PVC 3(1x4mm²) ne tub fleksibel Ø25mm
- Kabell kundra zjarrit me izolim PVC 5x6mm² ne tub korregato Ø32mm
- Kabell kundra zjarrit me izolim PVC 5x4mm² ne tub korregato Ø32mm
- Kabell kundra zjarrit me izolim PVC 5x16mm² ne tub korregato Ø40mm
- Kanaline plastike 100 x 60

# PLANI I SISTEMIT TE MBROJTJES ATMOSFERIKE




Rrjeti mbrojtes atmosferik do te behet mbi cati dhe ne vend te kubikeve te betonit do te vendosen morseta kryq lidhese per kete lloji siperfaqje.
Kalimi i zbritezve te tokezimit nga rrjeta mbrojtese tek zbritesi realizohet me kthesa >90°.
Fiksimi i percjellsit te bakrit per zbritjet realizohet me ganxha fiksuese çdo 60 cm.
Llogaritja e vleres se rezistences se tokezimit Rt te behet duke patur parasysh edhe kushtet klimaterike sidhe ato te mjedisit. Kjo rezistence duhet te jete Rt≤3om.
Elektroda e pare e cdo zbritesi do te vendoset ne nje pusete elektrike 30x30x30 cm.
Shkeputesi i tokezimit do te vendoset ne nje kuti shperndarese PT 4 jashte muri.
Detajet e fiksimit te shiritave rrufeprites dhe gjithe aksesoret e tjere te sistemit do te jene te standarteve europiane.

## LEGJENDA:

- Elektroda tokezimi te zinkuara D=16mm, L=1.5m ne pusete plastike 30x30x30cm
- Elektroda tokezimi te zinkuara D=16mm, L=1.5m n
- Shkeputes tokezimi dhe kuti PT4, IP65 me shenjte "toke"
- Morseta kryq per fiksimin e rrjetes
- Shtize rrufepritesi aliazh D16, L=0.5m + Bazamenti
- Shirit zinku Zn 30x3mm
- Percjelles i zhveshur Cu $35mm^2$

# PLANI I SISTEMIT TE INTERENETIT DHE TELEFONISE




Ne projekt eshte paraqitur skema e vendosjes se prizave te telefonise dhe te internetit .
Instalimet do realizohen me kanalina plastike e cila do te montohet pasi te kete perfunduar mobilimi.
Motimi do te behet mbi tavolinat e kompjuterave dhe te gjitha linjat do te perfundojne pa nderpreje nga posti i punes deri tek switchi, i parashikuar te vendoset tek laboratori i informatikes.
Per piken e lidhjes te instalimeve telefonike dhe kompjuterike eshte parashikuar te vendoset nje kuti shperndares jashte muri , e cila do te sherbej per te lidhur secilen nga linjat e mesiperme ne momentin kur shkolla lidhe kontraten me kompanite qe ofrojne keto sherbime.
Linjat do te jene me kabell FTP Cat6a per rrjetin kompjuterik dhe ate telefonik.Per linjat telefonike te parashikohet nje kasete e thjeshte me morseteri perkatese per lidhjet e hyrje-daljeve per telefonine.

## LEGJENDE:

| | |
|---|---|
| RJ45 RJ11 | Prize telefoni + komjuterike |
| | Kabell telefoni |
| | Kabell interneti |
| | Kuti shperndarese B/M PT 4 |
| | Kuti shperndarese J/M PT 5 |
| P.P | Post Pune 2 priza shuko 2P+T 16A, 220V, 1 Prize rrjeti RJ45, 1 Prize telefoni RJ11 |
| | Kanaline plastike 100X 60 |

# PLANI I SISTEMIT TE MBROJTJES NGA ZJARRI



**LEGJENDE:**

- Central zjarri i adresueshem, me 2 bateri 12V, 24ore autonomi
- Dedektor te adresueshem termik, optik ,jonik
- Buton me thyerje xhami, IP65
- Sirene alarmi e brendshme me drite flash
- Sirene alarmi e jashtme me bateri, 24ore autonomi
- Kabell PVC me izolim, zjarrdurues 2x1mm2
- Dedektor te adresueshem nxehtesie

# PLANI I SISTEMIT TE NDRICIMIT DHE DALJEVE EMERGJENTE



**LEGJENDE:**

Ndricues fluoreshent emergjrnce

Ndricues fluoroshent evakuimi , dalje

Percjelles i veshur me izolim PVC
3(1x1.5mm²) ne tub fleksibel PVC Ø20mm

# TABELA E MATERIALEVE

| Nr | EMERTIMI MATERIALIT | Karakteristikat | Njesia | Sasia | Vrejtje |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ndriçues luminesht | FL 2x36w, IP40; grile me reflektim pasqyre | cope | 96 | |
| 2 | Celes ndricimi njepolar | 220 V, 10 A | cope | 22 | |
| 3 | Kuti celes - prize + kapak + suport | 3 module | cope | 19 | |
| 4 | Tapa fallco | 1 modul | cope | 35 | |
| 5 | Percjelles i veshur me izolim PVC | 1.5$mm^2$ | ml | 1500 | |
| 6 | Percjelles i veshur me izolim PVC | 2.5$mm^2$ | ml | 150 | |
| 7 | Kabell elektrik FGR07 | 3X2.5$mm^2$ | ml | 110 | |
| 8 | Tub fleksibel PVC | Ø20mm | ml | 650 | |
| 9 | Kuti shperndarese | PT4 brenda murit | cope | 5 | |
| 10 | Ndriçues tip prozhektor LED | Led 60 W IP 65 | cope | 4 | |

| Nr. | EMERTIMI I MATERIALIT | Karakteristika | Njesia | Sasia | Verejtje |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Shirit Zinku | 30 x 3 | ml | 150 | |
| 2 | Percjelles i zhveshur Cu | 35 $mm^2$ | ml | 70 | |
| 3 | Elektrode tokezimi te zinkuara Zn tip Y | L = 1.5m | cope | 21 | |
| 4 | Shtize rrufepritese Zn me bazament | D ≥16; L = 0.6m | cope | 7 | |
| 5 | Shkeputes tokezimi | | cope | 7 | |
| 6 | Kuti shperndarese jashte muri | PT 4 ,IP 65 | cope | 7 | |
| 7 | Ganxha fiksuese | | cope | 100 | |
| 8 | Morseta kryq lidhese | | cope | 50 | |
| 9 | Puseta plastike elektrodash | 30x30x30 | cope | 7 | |
| 10 | Germim dheu | | $m^3$ | 15 | |

| Nr | EMERTIMI MATERIALIT | Karakteristikat | Njesia | Sasia | Vrejtje |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kuader elektrik brenda murit | 36 vende | cope | 1 | |
| 2 | Kuader elektrik brenda murit | 24 vende | cope | 1 | |
| 3 | Automat termoelektromagnetik diferencial | 380V; 63A;4P,dI=0.03A | cope | 1 | |
| 4 | Automat termoelektromagnetik diferencial | 380V; 32A;4P,dI=0.03A | cope | 1 | |
| 5 | Automat termoelektromagnetik | 380V; 20A;4P | cope | 1 | |
| 6 | Automat termoelektromagnetik | 380V; 40A;4P | cope | 1 | |
| 7 | Automat termoelektromagnetik | 220V; 16A; 2P | cope | 16 | |
| 8 | Automat termoelektromagnetik | 220V; 10A; 2P | cope | 4 | |
| 9 | Automat termoelektromagnetik diferencial | 220V;20A; 2P;Id=0.03A | cope | 2 | |
| 10 | Llampa sinjalizimi | 1.2w; 380V | cope | 6 | |
| 11 | Kuti shperndarse jashte murit | PT 5 | cope | 1 | |
| 12 | Kuti shperndarse brenda murit | PT 5 | cope | 18 | |
| 13 | Kuti shperndarse brenda murit | PT 8 | cope | 2 | |
| 14 | Kuti,suport, kapak per montim çelsash dhe prizash | 4 modulare brenda murit | cope | 2 | |
| 15 | Kuti,suport, kapak per montim çelsash dhe prizash | 3 modulare brenda murit | cope | 48 | |
| 16 | Suport, kapak per montim çelsash dhe prizash ne kanaline | 4 modulare brenda murit | cope | 16 | |
| 17 | Prize 2P+T, shuko universale | 220V;16A | cope | 52 | |
| 18 | Tapa | 1 modulare | cope | 48 | |
| 19 | Percjelles bakri P.V.C. Tip FG7(0)R 0.6/1kV | S=1x1.5$mm^2$ | ml | 600 | |
| 20 | Percjelles bakri P.V.C. Tip FG7(0)R 0.6/1kV | S=1x2.5$mm^2$ | ml | 1100 | |
| 21 | Percjelles bakri P.V.C. Tip FG7(0)R 0.6/1kV | S=1x4$mm^2$ | ml | 1200 | |
| 22 | Kabell bakri P.V.C. Tip FG7(0)R 0.6/1kV | S=3x2.5$mm^2$ | ml | 80 | |
| 23 | Kabell bakri P.V.C. Tip FG7(0)R 0.6/1kV | S=5x4$mm^2$ | ml | 15 | |
| 24 | Kabell bakri P.V.C. Tip FG7(0)R 0.6/1kV | S=5x6$mm^2$ | ml | 30 | |
| 25 | Kabell bakri P.V.C. Tip FG7(0)R 0.6/1kV | S=5x16$mm^2$ | ml | 100 | |
| 26 | Tub fleksibel | Ø20mm | ml | 320 | |
| 27 | Tub fleksibel | Ø25mm | ml | 350 | |
| 28 | Tub fleksibel | Ø32mm | ml | 35 | |
| 29 | Elektrode tokezimi Zn tip Y | L = 1.5m | cope | 6 | |
| 30 | Tub plastik seri e rende korrogato | Ø40mm | ml | 15 | |
| 31 | Puseta elektrike | 30 x 30 x 30 | cope | 1 | |

| Nr. | Pershkrimi i Materialeve | Karakteristika | Njesia | Sasia | Verejtje |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Priza interneti | RJ 45 | cope | 17 | |
| 2 | Priza telefoni | RJ 11 | cope | 17 | |
| 3 | Kabell interneti | cat 6a | ml | 200 | |
| 4 | Kuti ,Suport, Kapak | 3 modulare | cope | 1 | |
| 5 | Suport , kapak per montim celsash dhe prizash per kanaline | 3 Modulare | cope | 16 | |
| 6 | Tapa fallco | | cope | 16 | |
| 7 | Kuti shperndarese | PT 4 | cope | 1 | |
| 8 | Kuti shperndarese | PT 5 jashte muri | cope | 2 | |
| 9 | Switch | 24 porta | cope | 1 | |
| 10 | Kanaline plastike | 100 x 60 | ml | 25 | |
| 11 | Tub fleksibel | Ø20 | ml | 30 | |

| Nr. | Pershkrimi i Materialeve | Karakteristika | Njesia | Sasia | Verejtje |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Central alarmi per sinjalizim zjarri | 1 zonal, 230V , 24 ore autonomi | cope | 1 | |
| 2 | Baterie | 12 V | cope | 2 | |
| 3 | Sensore te adresueshem per gazra dhe nxehtesi termik - optik - jonik | | cope | 19 | |
| 4 | Pulsant alarm zjarri me thyerje xhami | IP 65 | cope | 1 | |
| 5 | Sirene alarmi e brendshme me drite flash | IP 42 | cope | 1 | |
| 6 | Sirene alarmi e jashtme me bateri, 24 ore autonomi | IP 30 | cope | 1 | |
| 7 | Kabell sinjalizim zjarri me izolim PVC, zjarrdurues | Tip RG-59 ,2x1$mm^2$ | ml | 320 | |
| 8 | Tub fleksibel PVC, zjarrdurues | Ø20mm | ml | 300 | |

| Nr. | Pershkrimi i Materialeve | Karakteristika | Njesia | Sasia | Verejtje |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ndricues fluoreshent emergjrnce | 1x 8W , IP 20 ,T=2 ore | cope | 12 | |
| 2 | Ndricues fluoroshent evakuimi , dalje | 1x 8W , IP 20 ,T=2 ore | cope | 3 | |
| 3 | Percjelles bakri | 3x(1x1.5)$mm^2$ | ml | 450 | |
| 4 | Tub fleksibel PVC | Ø20mm | ml | 150 | |

MIRATOI:
KRYETARI I BASHKISE DIBER
Rahim SPAHIU

**PREVENTIV**

**OBJEKTI :RIKONSTRUKSION I SHKOLLËS 9 - VJEÇARE DOVOLAN**

**EMËRTIMI : SISTEMI I NGROHJES ME KALDAJE ME PELET**

**B. PUNIME MEKANIKE**

| Nr | Shenja e manualit | Emërtimi i materialit | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlefta |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **PUNIME MEKANIKE** | | | | |
| 1 | An | F.V. Sistemi i ngrohjes me tuba çeliku dhe aksesorë | copë | 1.00 | 150,000.00 | 150,000.00 |
| | | | | | **SHUMA I** | **150,000.00** |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | **VLERA E PAISJEVE ME TVSH** | | | | |
| 1 | An | Kaldajë me dru dhe pelet; fuqia nominale 100 kW me panel kontrolli ; ndezje automatike me rezistencë ; aksesorë dhe valvol sigurie | komplet | 1.00 | 1,069,297.00 | 1,069,297.00 |
| 2 | An | Pompë qarkullimi uji të ngrohtë sanitar ;presioni maksimal 10 bar, prurja deri në 19 $m^3/h$; prevalenca deri në 12m | copë | 1.00 | 60,000.00 | 60,000.00 |
| 3 | An | Radiator 600 W me trup alumini | copë | 161.00 | 1,415.00 | 227,815.00 |
| 4 | An | Radiator 800 W me trup alumini | copë | 108.00 | 1,786.00 | 192,888.00 |
| | | | | | **SHUMA I** | **1,550,000.00** |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | **SHËNIM:** | | | | |
| | | Çmimet e mësipërme të preventivit janë bazuar tek Manuali 2 e 3 sipas VKM nr.629 | | | | |
| | | datë 15.09.2015 si dhe tek çmimet e dala nga testimi i tregut . | | | | |

# RELACION TEKNIK

## RIKONSTRUKSION SHKOLLA DOVOLAN

# Permbajtja

- **INSTALIME ELEKTRIKE**


1. Te dhenat e objektit
2. Furnizimi me energji elektrike i objektit
3. Rrjeti elektrik i ndricimit
4. Ndricimi emergjent dhe daljet emergjente
5. Rrjeti elektrik i fuqise
6. Sistemi telefonik dhe internet
7. Sistemi i mbrojtjes nga zjarri
8. Sistemi i mbrojtjes atmosferike dhe tokezimit

## 1- INSTALIMET ELEKTRIKE

### 1.1 Të dhënat e objektit

Për rikonstruksionin e objektit: **Shkollë 9-vjeçare, Dovolan, Peshkopi** të gjithë materialet që do të përdoren, do të jenë produkete të çertifikuara “CE”, produkte të standarteve të Bashkimit Europian, për të ndërtuar kështu një objekt sa me funksional ashtu edhe bashkëkohor.

Në rikonstruksionin e ketij objekti do te perfshihen ndertimi i sistemeve elektrike te meposhtme :

- projekti i rrjetit elektrik, ndriçimit
- projekti i rrjetit telefonik dhe kompjuterik
- sistemi i mbrojtjes nga zjarri
- ndriçimi emergjent dhe i daljeve emergjente
- mbrojtja atmosferike

Projektimi i sistemit elektrik për objektin: **Shkollë 9-vjeçare, Dovolan, Peshkopi** do të bëhet në përputhje të plotë me strukturën e saj ndërtimore, arkitektonike dhe konstruktive, duke ju përshtatur dhe përgjigjur kërkesave të te shkollave. Ndërtimi i sistemit elektrik do të lidhet ngushtë me hapsirën e brendshme të godinës, ndarjen e saj në zona.

### 1.2 Furnizimi me energji elektrike i objektit

Furnizimi i godinës me energji do të bëhet nga shtylla ekzistuese ne krah te godinës. Linja do të vijë ajrore dhe do të futet direkt në panelin e katit të parë i cili do të shërbejë si panel kryesor dhe si panel furnizues për katin.

Shpërndarja do te bëhet siç është parashikuar në projekt. Do te furnizohen të gjitha sistemet elektrike te kabllove nga panelet TU deri ne pikat fundore të konsumatorit apo edhe të pajisjes. Kabllot e përdorur do të jenë të tipit FROR dhe FG7OR, sipas normës CEI 20-20, Classe 5, me cilesi te larta antizjarr dhe pa gazra toksike sipas normës CEI 20-38. Norma aplikuar CEI 20-20.

Rrjeti shpërdarës përbëhet nga paneli kryesor i cili duhet të furnizojë katin përkatës me energji dhe panelin e katit tjetër.
Paneli kryesor shpërndarës duhet të jetë plastik jashtë murit IP65.

Pajisjet mbrojetëse duhet të jenë automate sipas normës CEI 60898 dhe CEI 60947-2

Automatët diferenciale dhe magneto-termik diferencialë sipas normës CEI 61008, sigurojnë perveç mbrojtjes nga mbingarkesa dhe lidhjet e shkurtra edhe mbrojtjen nga rrymat e rrjedhjes me tokën.

Pajisjet komutuese sipas normës CEI 60947-3, janë ato pajisje të cilat bëjnë të mundur takimin apo stakimin e ngarkeses por nuk mund ta mbrojnë rrjetin nga lidhjet e shkurtra mbingarkesa.

Panelet shpërndarës duhet të jenë me hapsirën e nevojshme për vendosjen e të gjithë automatëve dhe të llogariten me një rezerevë prej 15-20% për zhvillime të mundshme në të ardhmen. Këta panele duhet të plotesojnë kriteret termike të ngrohjes së automatëve, të kenë vendin për vendosjen e klemave dhe te fijeve të kabllove, të jenë të montueshëm në dysheme ose në mur sipas kerkesës. Panelet duhet të jenë plastik me kapak transparent, duke lehtësuar punën e personelit mirmbajtës, të jenë të plotësuar me aksesorët e nevojshme për sigurinë e kabllimit dhe të gjithë pajisjeve të tjera. Një panel i tillë lehtëson punën e autometëve nëpërmjet qarkullimit të brendshëm të ajrit dhe bën të mundur një shpërdnarje të automatëve sipas fazave të ndryshme dhe kërkesave të objektit.

Paneli kryesor i TU duhet të përmbajë të paktën:
Automatin kryesor trefazor 400 V, amperazhi varet nga ngarkesa.
Sinjalizuesit e fazave me tregim në kapakun e tij. Klemet e tokëzimit që lidhen me sistemin e tokëzimit .
Montimi i tij dhe i përbërësve, duhet të bëhet nga specialisti elektrik nën mbikeqyrjen e Inxhinierit. Te gjitha lidhjet e kabllove / telave brenda panelit, duhet të bëhet me anë të klemave bashkuese dhe jo me nastroband.
Vete paneli duke qene metalik, duhet të lidhet me sistemin e tokëzimit.

Panelet e shpërndarjes në kate janë pika shpërndarje të TU, të cilat përveç shpërndarjes së tensionit për katin, bëjnë të mundur edhe selektimin e mbrojtjes.
Këto panele janë të tipit që montohen mbi suvatim.



Panel Jashtë Murit

Elementet e domosdoshem të këtyre paneleve janë:

Automati kryesor 3 fazor magnetotermik dhe me mbrojtje diferenciale, amperazhi varet nga ngarkesa;

Automatet mangeto-termik njëfazore të fuqise (prizave), të cilet në varësi të prizave që do të furnizohen kanë edhe amperazhin e tyre;

Automatet mangeto-termik të ndriçimit, të cilët në varësi të ndriçuesave që do të furnizohen kanë edhe amperazhin e tyre;

Rekomandohet që sistemi i ndriçimit të jetë i ndarë nga ai i fuqisë.

| SPECIFIKIMET TEKNIKE | |
|---|---|
| Min. temperaturës instalimit | -25 °C |
| Max. temperaturës instalimit | 60 °C |
| IK Kod | 07 |
| Testi i ngrohjes së telave | 750 °C |
| | |

**1.3 Kabllot dhe telat**

Të gjitha telat dhe kabllot duhet të kenë çertifikatën e aprovimit të autoriteteve lokale përkatëse dhe çertifikaten e fabrikës.

Telat duhet të jenë përçues të thjeshtë bakri të izoluara (veshura) me shtrese PVC për tu futur brenda tubave.

Izolimi i telave dhe këllëfi duhet të jenë me izolim të ngjyrosur për të identifikuar fazën dhe nulin.

Të gjitha rastet kur kabllot PVC përfundojnë në një panel shpërndarës siguresash, pajisje elektrike etj, duhet lënë një sasi kablli të lirshëm për të lejuar në të ardhmen, zhveshjen e rilidhjes me terminalet pa shkaktuar tërheqje të tyre.

Kabllot për çdo seksion të instalimit duhet të mbyllen nëper tuba dhe ne sistemin e kutive futese permbledhese për atë ndarje të veçantë.

Zhveshja e izolimit ne kabllot e izoluara me PVC duhet të kryhet duke përdorur nje vegël të përshtatshme për zhveshjen, dhe jo një thikë.

Telat duhet të jenë të ngjyrosura për identifikim. E zeza duhet të përdoret për përçuesit e neutrit, jeshilja/e verdha duhet të përdoren për përçuesit e tokës dhe ngjyra e kuqe/blu dhe e verdhë për përçuesit fazë. Të njëjtat ngjyra duhet të

përdoren për lidhjet në të njëjtet përçues fazë. Të njëjtat ngjyra duhet të përdoren për lidhjet në të njëjtën fazë furnizimi për të gjithë instalimet.

Të gjitha kabllot tek duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të kenë në anë etiketën dhe vulën e prodhuesit ose prova të tjera të origjines.
Numri i kabllove që duhen instaluar në tuba duhet të jetë aq sa të lejojë futjen e lehtë pa dëme të kabllove dhe nuk duhet të zërë në asnjë rrethanë më shumë se 40% të hapësirës. Instalimi duhet të përputhet me KTZ në Shqipëri.

Kabllo fleksibël (me disa tela shumëfijësh për çdo tel)

Të gjitha kabllot duhet të kenë çertifikatën e aprovimit të autoriteteve lokale përkatëse dhe çertifikatën e fabrikës.

Izolimi PVC i kabllove duhet të durojë 600/1000 V, shumetelësh ose me tel tek me përçues të thjeshtë prej bakri të temperuar të izoluara me PVC dhe me një këllëf PVC-je përfundimtar të sipërm.

Të gjithë kabllot e futur nëpër tuba duhet të jenë të izoluara me polivinil klorid dhe me përçueshmëri të lartë.

Kabllot fleksibël janë të përbërë nga tela shumëfijesh dhe në varësi të tyre kemi:
Kabllo me 3 tela, 1 fazë, 1 nul, 1 toka (për sistemin njëfazor)
Kabllo me 4 tela, 3 Faza dhe 1 nul (për sistemin trefazor pa tokezim)
Kabllo me 5 tela, 3 faza, 1 nul dhe 1 toka (përsistemin trefazor më tokëzim)

Kabllot fleksibel duhet ti kenë telat të ngjyrosura për identifikim. E zeza duhet të përdoret për përçuesit e neutrit, jeshilja/e verdha duhet të përdoren për përçuesit e tokës dhe ngjyra e kuqe/blu dhe e verdhë për përçuesit fazë. Të njëjtat ngjyra duhet të përdoren për lidhjet në të njëjtët përçues faze. Të njëjtat ngjyra duhet të përdoren për lidhjet në të njëjtën fazë furnizimi për të gjithë instalimet.
Asnjë kabëll me seksion më të vogël se 2.5 mm² s'duhet të përdoret me instalim vetem nëse përmendet në veçanti. Përçuesit e tokës duhet të kenë një masë minimale të kërkuar nga rregullorja.

**1.4 Tubat dhe Kutitë**

Instalime elektrike mund të bëhen në dy mënyra:
Nën suva të futura në tuba PVC fleksibël
Mbi suva në kanalina PVC

Aksesoret e instalimeve nën suva janë:

Tubat fleksibël PVC të dimensioneve të ndryshme në varësi të dimensionit dhe të numrit të telave që do të futen në të.

Kutitë për fiksimin e prizave ose të çelsave .Të gjitha këto vendosen para se të bëhet suvatimi.

Për kryerjen e instalimeve elektrike të futura nën suva duhet të ndiqet rradha e punës si mëposhtë:

Hapja e kanaleve në mur me dimension të tillë që të vendoset lirshëm tubi fleksibël dhe me thellësi të tillë që të mos dalë mbi nivelin e suvasë përfundimtare.

Vendosen tubat fleksibël dhe kutitë prej PVC të cilët provizorisht fiksohen me allçi (më vonë mbyllen kanalet me llaç suvatimi)

Pasi është kryer suvatimi, futen telat ose kabllot, me anë të udhëzuesit të tyre, të cilat duhet të hyjnë lirshëm dhe të lihet në të dy krahët një sasi e mjaftueshme për kryerjen e lidhjeve dhe montimeve.

Tubat fleksibël duhet të jenë sipas standarteve përkatëse të mëposhtme:

Përputhja me standartet: CEI 23-32.
Materiali PVC.
(Rezistenca) Qëndrueshmëria e izolimit: 100 MΩ
Shkalla IP: IP40
Qëndrueshmëria ndaj goditjeve: IK08
Temperatura e instaluar: -5/60 °C.

Kanalet dhe vendosja e tubave fleksibel PVC duhet të bëhet në distancë 0.4 m mëposhtë nga niveli i tavanit në vijë të drejtë horizontale dhe zbritjet për çelsat ose prizat të behën vertikale të drejta dhe jo me kënd ose në forme harku.

Kutitë shpërndarëse në varësi të sistemit që do të përdoret janë për nën suvatim ose mbi suvatim keshtu që mënyra e fiksimit të tyre është ose me allçi ose me anë të vidave me upa.

Përmasat e kutive shpërndarëse variojnë sipas rastit dhe nevojës. Ato janë në formë rrethore, katrore ose drejtkëndëshe dhe kapaket e tyre mbyllës janë me ngjyra të ndryshme.

E rendesishme eshte qe lidhja e telave/kabllove brenda në kutitë shpërndarëse të realizohet me anë të klemeve bashkuese ose fundore.

Lidhjet fleksible përdoren zakonisht në laboratore dhe konsistojnë në atë që linja elektrike shkon deri në afërsi të pajisjes me fund kuti shpërndarëse dhe prej aty deri në pajisjen që do të lidhet përdoret një lidhje fleksible jashtë murit. Për këtë duhet që dalja e kabllit nga kutia shpërndarëse të jetë stabile, e izoluar dhe brenda kushteve teknike. Kablli vetë të jetë i izoluar me dy shtresa izolimi dhe të futet në tuba fleksibël. Lidhja e tij me pajisjen të bëhet në morseterinë e saj.

Vendodhja e çelsave të ndriçimit tregohet sipas projektit dhe skicave të bëra nga inxinieri elektrik projektues.

Në përgjithsi çelsat e ndriçimit gjatë gjithë ndërtesës duhet të jenë të përshtatshme për montim të rrafshet (nën suvatim). Për njësitë e çelsave të rrafshet brenda ndërtesës duhet një tjetër i ngjashëm si mëposhtë:

1P-16A, ngjyra e bardhe. Çelsat duhet të jenë të tipit të ndërprerjes së ngadaltë "quick make sloëbreak" të projektuara për kontrollin e rrjetit AC. Duhet të kenë një shkallë minimale prej 10A.

Çelsat mund të jenë të tipit "broad rocker", për të dhënë njësi të fishuara çelsash që nevojitet deri sa të ndryshohet specifikimi. Çelsat duhen të montuara në një rrjet elektrik për të siguruar, shtrirjen e duhur, kur kutitë e kabllove metalike të përputhen rrafsh me suvatimin e murit .

Çelsat sipas vendit ku do të përdoren dhe mënyres së takim-stakimit do të jenë:

Çelsa një polar
Çelsa deviat
Çelsat me llampë sinjalizimi me stakim kohor

Çelsat një polar përdoren zakonisht në ambiente të vogla ku kemi një numër të vogël (1 ose 2) ndriçuesa.

Çelesat deviat janë të përdorshëm në ato ambiente ku kemi dy hyrje/dalje, pasi ata takojnë ndriçuesit në njerën hyrje/dalje dhe mund të stakojnë në hyrjen/daljen tjetër, ose mund të përdoren nëpër korridore.

Çelsat me llampë sinjalizimi me stakim kohor janë të përdorshëm nëpër shkallë, nëpër korridore etj.

Një sistem i kompletuar me njësi prizash duhet siguruar sipas projektit dhe skicave të bëra nga inxinieri elektrik projektues.

Të gjitha prizat që do të montohen duhet të jenë të tipit me tokëzim.

Prizat ashtu si edhe çelsat mund të jenë të tipit që montohen nën suvatim ose mbi suvatim.

Prizat i ndajmë sipas detyrës që do të kryejnë:

Priza tensioni njëfazore
Priza telefoni
Priza TV

Prizat e tensionit njëfazore siç tregohen edhe në figurën e mëposhtme kanë 1 pin për Fazën, 1 pin për nulin dhe një pin për tokën fig. 1 ose kontaktet e tokës fig.2.




Prizë bivalente Prizë shuko universal

Gjithe prizat, derisa të bëhet një tjetër specifikim, duhet të jene te tipit 16 amper 2-pin. Ato duhet të kenë montim rafsh duhet të kenë një ngjyre që të shkojë me paftat e çelsave të ndriçimit.

## 1.5 Rrjeti elektrik i ndriçimit

Sistemi i ndriçimit do të realizohet me instalime të brendshme, me tuba fleksibël të cilët do të instalohen brenda murit.

Instalimet me tuba fleksibël duhet të plotësojnë të gjitha kushtet teknike të instalimeve elektrike.

Ndriçimi i objektit do të bëhet me ndriçues 4x18W me mbrojtje IP20 dhe IP54 sipas skemave në vizatim. Në tualete do të përdoren ndriçues 2x18W. Pavarsisht ambjentit i cili do të ndriçohet llogaritja e ndriçimit është bërë sipas normës EN 12464 duke krijuar një siperfaqe uniforme të ndriçuar mirë në çdo pjesë të saj dhe të qetë për punën e personelit dhe të gjithë njerëzve.






Ndriçim do të jetë i ndryshëm në varësi të ambjentit si zyra, koridore, salla, shkallë etj. E rekomandueshme është të përdoren ndriçues indirekt për të eliminuar flukset e larta të dritës shpeshherë të pakëndshme. Karakteristika e tyre është ndriçimi i qetë, i njëtrajtshëm, shkalla e lartë e mbrojtjës etj.

## 1.6 Rrjeti ndriçimit emergjencës

Ndricimi i emergjencës është i nevojshëm për ndricimin e pjesshëm të ambjeneteve të vecanta të godinës gjatë kohës së ndërprerjes së energjisë nga rrjeti dhe futjes në punë të ushqimit back Up ose gjenerator. Sipas normës CEI 23- 34 ndricuesit e emergjencës duhet të jenë të pajisur me baterinë e ushqimit ose në mungesë të saj të ushqehen nga një grup UPS-i i vencantë dhe i pavarur me autonomi të madhe. Në figurën me poshte tregohen ndricues emerngjence me baterinë e vetë të inkluduar.



Ndricues emergjence dhe kiti i baterise

Ndricuesi i emergjencës duhet të ketë një fuqi 8W dhe autonomi të baterisë së vetë jo më të vogël së 2 orë. Është e rëndësishme dhe e rekomandueshme përdorimi i sistemit të përqëndruar të ushqimit të ndriçimit të emergjencës. Ky sistem përvec sigurimit të një ushqimi të sigurt siguron edhe një mirëmbajtje dhe kontroll të vazhdueshëm të të gjithë sistemit të ndricimit të emerngjencës.



Ndricues emergjence dhe kiti i baterisë

Një sistem i tille kontrollon gjendjen e llampave të emerngjencës. Është e këshillueshme për objektin ndriçmi i emergjencës të jetë i përfshirë në ndriçmit “exit”. Në kçtë mënyrë krahas ndriçimit të nevojshem personeli ka të dallueshme edhe shenjat që tregojnë daljen.

## 1.7 Sistemi telefonik dhe internetit

Sistemi i rrjetit telefonik dhe sinjaleve te internetit.

Kontraktori duhet të instalojë një sistem rrjeti telefonik dhe internetit me tela dhe kuti shpërndarëse në mënyre që të krijojë një komunikim telefonik nëpërmjet telave nga burimi i linjës dhe dhoma e aparaturës në të gjithë godinën një ndarje e veçante dhe tela të veçanta do të përdoren për te mbajtur sistemin telefonik dhe te internetit plotësisht të ndarë nga shërbime të tjera.

Këto linja montohen së bashku në të gjithë godinën. Kur në të gjitha degëzimet do të përdoren klema bashkuese të izoluara në mënyre të mos kemi humbje se sinjalit data.

Prizat e rrjetit telefonik dhe internetit do të vendosen në të njëjtën lartësi me prizat e tensionit dhe rekomandohen në lartësi 0.4 m. Ato janë te tipit mbi suvatim ( që inkastrohen në kanaleta).
Prizat e rrjetit telefonik duhet te jene RJ-11 kategoria 5, ndersa ato te internetit RJ-45 kategoria 6, ngjyrë e bardhë (ose të njëjtë me ngjyrën e prizave të tensionit dhe celsave të ndriçimit).

## 1.8 Sistemi i mbrojtjes nga zjarri

Sistemi i mbrojtjes nga zjarri do të jetë konvencional, zonal.
Shumica e paneleve të alarmeve të zjarrit kanë disa zona të detektuara, duke përfshirë një përzierje të detektorëve të zjarrit dhe butonave të thirrjes. Në mënyrë që të limitohen të gjithë gabimet, dhe të limitohen të gjithë zonat e kërkuara në rast

zjarri, sasia e zonave të zjarrit të detektuara është e limituar ne 2000$m^2$, me një distancë jo më larg se 60m për të lokalizuar një zjarr.
Gjithashtu, zonat nuk duhet të mbulojne më shumë se një kat, vetëm nëse vlera totale e katit është më pak se 300$m^2$. Si rezultat, nëse zona nuk eshtë shumë e vogël atëherë sistemi duhet të përmbajë disa zona të detektuara.

Instalimet për detektimin e zjarrit realizohen me kabëll Tip RG-59, S=2x0.8 $mm^2$, i kuq.
Detektoret e tymit te instalohen direkt në tavan si dhe sirena alarmi të brendshme në mure anësore.
Pulsanti manual sinjalizimi "Alarm zjarri" i cili eshte i posaçëm për këto sisteme, me xham përpara që thyhet kur duam ta shtypim pulsantin me dorë, vendosen ne vende të dukshme pranë dyerve dalëse në lartesinë h=120cm nga niveli ±0.0 i dyshemese.
Element alarmi optik (me dritë që pulson) dhe zanor (sirenë), vendosen mbi dyeret dalëse (lartesi h=230cm) pranë pulsanteve manual.
Çentrali i alarmit për detektimin e zjarrit do të jetë zonal me qëllim mbulimin e të gjitha zonave të ndara në objekt.
Çentrali i alarmit të instalohet në lartesinë +1.4m nga niveli ±0.00 i dyshemesë.

## 1.9 Sistemi i mbrotjes atmosferike dhe tokëzimi

Tokëzimi: Sistemi i tokëzimit do të bëhet me përcjellës të zhveshur bakri Cu 35$mm^2$ të futur në tokë në një thellësi jo më pak se 50 cm. Sistemi do të ndërtohet si topologji radiale duke filluar në çdo pikë të shkarkuesit. Rrufepritësit dhe sistemi i tokëzimit do te lidhen mbi nivelin e tokës në lartësi jo më të madhe se 1m (lidhje që bëhet me bulona për sistemin e kontrollit). Kjo lidhje vendoset në një kuti dhe do të shërbejë për matjet periodike dhe mirëmbajtje. Për cdo zbritës të shtizave do venoset elektrodë në pusetë kontrolli 30x30x30cm dhe shkëputës tokezimi i cili do të vendoset në zbritës 40cm mbi nivelin e ndërtesës dhe do të futet në një kuti PT-5, jashtë murit IP65.

Një sistem tokëzimi shtesë duhet bërë për të mundësuar barazimin e potencialit. Ky sistem tokëzimi duhet të lidhet me shufrën kryesore prej bakri barazpotenciale të vendosur në panelin kryesor të tensionit të ulët.

Projekti parashikon mbrojtjen diferenciale me rele diferenciale 0.03A,
$R_t < 4\ \Omega$ (ne cdo stinë të vitit)
Mbrojtjen nga LSH me automat termo-elektro-magnetik.
Tokëzimi i punës realizohet pranë çdo shkalle me anë të panelit Panelit Kryesor, tokëzohet përcjellësi i nulit të kabllove furnizuese të prizave.

Nëse nuk realizohet vlefta e R tokes ≤ 4 Ω, me numrin e elektrodave te paraqitura ne projekt, atëherë duhet te realizohet tokëzim artificial, duke përpunuar vendin ku do të bëhet tokëzimi dhe duke rritur numrin e elektrodave.

Në projekt është parashikuar që mbrojtja nga rrufetë dhe sistemi i tokëzimit të jenë të lidhura bashkë dhe që të dyja të arrijnë një vlerë se ≤ 4 Ω, duhet të realizohet tokëzim artificial.

Sistemi i mbrojtjes atmosferike është shumë i domosdoshem, për vetë kushtet atmosferike dhe vendodhjen gjeografike në të cilat ndodhet vendi ynë.

Sistemi i mbrojtjes atmosferike është dhe duhet të ngrihet i pavarur, nga ai i sistemit të tokezimit dhe të plotesojë kushtet e zbatimit sipas KTZ –së së Shqipërisë.

Vlera e rezistences të këtij sistemi duhet të jetë më e vogël se 1 Ω. Gjate punës për ketë sistem (pasi te jenë vendosur elektrodat) kryhen matje të R dhe në rast se ajo eshte me e madhe se 1 Ω, atehere duhet rritur numri i elektrodave derisa të arrihet kjo vlere. Matjet duhen peërsëritur dy herë. Njeë herë në tokë me lageshtirë dhe një herë me tokë të thatë.

Materialet që do të përdoren për këtë sistem (shiritat, elektrodat që do të futen në tokë, shigjeta, bulonat fiksues etj.) duhet të jenë të gjitha prej zinku ose hekur të galvanizuar.

Shiritat duhet të jenë me përmasa40 mm x 4 mm ose 30 mm x 3 mm, ose shufër me diametër min. 10 mm.

Elektrodat duhet të jenë me gjatësi 1.5 m, si në rastet kur do të përdorët hekur në formë “L” (50 x 50 x 4 mm) i galvanizuar, ashtu edhe kur do të përdoren elektroda zinku të prodhuara nga fabrika.

Shtizat duhet të jenë zinkato 0.6 m të kompletuara me bazament dhe vendosen mbi mbi pikat më të larta të objektit.

Bulonat dhe dadot që do të përdoren për fiksim të shiritit me elektrodat duhet të jenë min. M 12.

Shënim: të gjitha lidhjet duhet të bëhen të tilla që të kemi një përcjellshmëri të lartë, si dhe të mos kemi korozion dhe oksidim të pikave të lidhjeve.

MIRATOI:

KRYETARI I BASHKISE DIBER
Rahim SPAHIU

**PREVENTIV**

**OBJEKTI : RIKONSTRUKSION I SHKOLLËS 9 - VJEÇARE DOVOLAN**

**EMËRTIMI : INSTALIMET ELEKTRIKE**

**C. PUNIME ELEKTRIKE**

| Nr | Shenja e manualit | Emërtimi i materialit | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlefta |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **I.INSTALIMET E NDRICIMIT** | | | | |
| 1 | 2.485/1 | F.V Çeles ndricimi 1 polar 220V 10A | copë | 22.00 | 443.00 | 9,746.00 |
| 2 | 2.487/a | F.V Kuti,suporte,kapak per celsa e priza 3 Modul | copë | 19.00 | 277.22 | 5,267.21 |
| 3 | An | F.V Tapa fallco 1 Modul | copë | 35.00 | 63.25 | 2,213.61 |
| 4 | 2.481/1 | F.V Percjelles I veshur me PVC ,Cu,1.5 mm² | ml | 1,500.00 | 32.00 | 48,000.00 |
| 5 | 2.481/2 | F.V Percjelles I veshur me PVC ,Cu,2.5 mm² | ml | 150.00 | 49.00 | 7,350.00 |
| 6 | An | F.V Kabell me izolim PVC FG7OR 3x2.5 mm² | ml | 110.00 | 251.00 | 27,610.00 |
| 7 | 480/2 | F.V Tub PVC fleksibel Ø 20 mm | ml | 650.00 | 120.00 | 78,000.00 |
| 8 | An | F.V Kuti shperndarese brenda murit PT-4 | copë | 5.00 | 158.00 | 790.00 |
| | | | | | **Shuma I** | **178,976.82** |
| | | **II.INSTALIMET E FUQIS** | | | | |
| 1 | 2.490/f | F.V Panel plastike brenda murit 36 M | copë | 1.00 | 3,289.00 | 3,289.00 |
| 2 | An | F.V Panel plastike brenda murit 24 M | copë | 1.00 | 3,166.00 | 3,166.00 |
| 3 | An | F.V Automat diferencial termo elektro-magnetik ,63A,4P,dI=0.03A | copë | 1.00 | 6,367.00 | 6,367.00 |
| 4 | An | F.V Automat diferencial termo elektro-magnetik ,32A,4P,dI=0.03A | copë | 1.00 | 4,464.00 | 4,464.00 |
| 5 | An | F.V Automat termo elektro-magnetik 3P+N 380V,20A | copë | 1.00 | 2,370.00 | 2,370.00 |
| 6 | An | F.V Automat termo elektro-magnetik 3P+N 380V,40A | copë | 1.00 | 2,370.00 | 2,370.00 |
| 7 | An | F.V Automat termo elektro-magnetik 220V,16A,1P+N | copë | 16.00 | 749.00 | 11,984.00 |
| 8 | An | F.V Automat termo elektro-magnetik 220V,10A,1P+N | copë | 4.00 | 749.00 | 2,996.00 |
| 9 | An | F.V Automat diferencial termo elektro-magnetik 30mA,220V,20A,1P+N | copë | 2.00 | 3,057.00 | 6,114.00 |
| 10 | 2. a-120 | F.V Llambe sinjalizimi 220V,1.2W | copë | 6.00 | 597.54 | 3,585.24 |
| 11 | An | F.V Kuti shperndarese jashte murit PT-5 | copë | 1.00 | 305.00 | 305.00 |
| 12 | An | F.V Kuti shperndarese brenda murit PT-5 | copë | 18.00 | 305.00 | 5,490.00 |
| 13 | An | F.V Kuti shperndarese brenda murit PT-8 | copë | 2.00 | 692.00 | 1,384.00 |
| 14 | 2.487/b | F.V Kuti,suporte,kapak per celsa e priza 4 Modul | copë | 2.00 | 364.35 | 728.71 |
| 15 | 2.487/a | F.V Kuti,suporte,kapak per celsa e priza 3 Modul | copë | 48.00 | 277.22 | 13,306.65 |
| 16 | AN | F.V Kuti,suporte,kapak per kanaline 4 Modul | copë | 16.00 | 390.00 | 6,240.00 |
| 17 | 2.485/g | F.V Priza universale ,2P+T ,Shuko 220 V,16 A | copë | 52.00 | 510.00 | 26,520.00 |
| 18 | An | F.V Tapa fallco 1 Modul | copë | 48.00 | 63.25 | 3,035.80 |
| 19 | 2.481/1 | F.V Percjelles I veshur me PVC ,Cu,1.5 mm² | ml | 600.00 | 32.00 | 19,200.00 |
| 20 | 2.481/2 | F.V Percjelles I veshur me PVC ,Cu,2.5 mm² | ml | 1,100.00 | 49.00 | 53,900.00 |
| 21 | 2.481/3 | F.V Percjelles I veshur me PVC ,Cu,4 mm ² | ml | 1,200.00 | 60.00 | 72,000.00 |
| 22 | An | F.V Kabell me izolim PVC FG7OR 3x2.5 mm² | ml | 80.00 | 251.00 | 20,080.00 |
| 23 | An | F.V Kabell me izolim PVC FG7OR 5x4 mm² | ml | 15.00 | 426.00 | 6,390.00 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 24 | An | F.V Kabell me izolim PVC FG7OR 5x6 mm² | ml | 30.00 | 567.00 | 17,010.00 |
| 25 | An | F.V Kabell me izolim PVC FG7OR 5x16 mm² | ml | 100.00 | 1,307.00 | 130,700.00 |
| 26 | 480/2 | F.V Tub PVC fleksibel Ø 20 mm | ml | 320.00 | 120.00 | 38,400.00 |
| 27 | 480/3 | F.V Tub PVC fleksibel Ø 25 mm | ml | 350.00 | 161.82 | 56,636.11 |
| 28 | 480/5 | F.V Tub PVC fleksibel Ø 32 mm | ml | 35.00 | 220.17 | 7,705.88 |
| 29 | 2.a-73 | F.V Elektroda tokezimi Zn, L=1.5m,D16 | copë | 6.00 | 1,315.43 | 7,892.56 |
| 30 | An | F.V Tub korregato Ø 40 mm | ml | 15.00 | 178.00 | 2,670.00 |
| 31 | 3.An/55 | F.V Puseta per elektroda 0.3x0.3x0.3 | copë | 1.00 | 2,739.89 | 2,739.89 |
| | | | | | **Shuma II** | **539,039.84** |
| | | **III.INSTALIMET E NDRICIMIT TE EMERGJENCES** | | | | |
| 1 | 2.481/1 | F.V Percjelles I veshur me PVC ,Cu,1.5 mm² | ml | 450.00 | 32.00 | 14,400.00 |
| 2 | 480/2 | F.V Tub PVC fleksibel Ø 20 mm | ml | 150.00 | 120.00 | 18,000.00 |
| | | | | | **Shuma III** | **32,400.00** |
| | | **IV.INSTALIMET E MROJTJES ATMOSFERIKE** | | | | |
| 1 | 2.a-98 | F.V Shirit zinku 30x3mm | ml | 150.00 | 1,639.54 | 245,931.72 |
| 2 | 2.a-93 | F.V Percjelles I zhveshur ,Cu 35mm2 | ml | 70.00 | 1,640.00 | 114,800.00 |
| 3 | 2.a-73 | F.V Elektroda tokezimi Zn, L=1.5m,D16 | copë | 21.00 | 1,315.43 | 27,623.96 |
| 4 | | F.V Shtiza rrufepritese Zn D=16;L=0.6m | copë | 7.00 | 1,400.00 | 9,800.00 |
| 5 | An | F.V Shkeputes tokezimi | copë | 7.00 | 701.00 | 4,907.00 |
| 6 | An | F.V Kuti shperndarese brenda murit PT-4 | copë | 7.00 | 158.00 | 1,106.00 |
| 7 | An | F.V Ganxha fiksuese | copë | 100.00 | 203.00 | 20,300.00 |
| 8 | An | F.V Morseta kryq lidhese | copë | 50.00 | 1,700.00 | 85,000.00 |
| 9 | 3.An/55 | F.V Puseta per elektroda 0.3x0.3x0.3 | copë | 7.00 | 2,739.89 | 19,179.20 |
| 10 | 2.15 | Germim dhe mbushje dheu | m3 | 15.00 | 654.00 | 9,810.00 |
| | | | | | **Shuma IV** | **538,457.88** |
| | | **V.INSTALIMET E MBROJTJES NGA ZJARRI** | | | | |
| 1 | AN | Montim I sistemit te mbrojtjes nga zjarri | komp | 1.00 | 14,850.00 | 14,850.00 |
| 2 | AN | F.V Kabell PVC,zjare dures tip RG-59,2x1mm2 | ml | 320.00 | 131.00 | 41,920.00 |
| 3 | 480/2 | F.V Tub plastik fleksibel d=20 | ml | 300.00 | 120.00 | 36,000.00 |
| | | | | | **Shuma V** | **92,770.00** |
| | | **VI.INSTALIMET E SISTEMIT KOMPJUTERIK** | | | | |
| 1 | An | F.V Prize rrjeti kompjuterik RJ45, | copë | 17.00 | 724.00 | 12,308.00 |
| 2 | An | F.V Prize rrjeti telefonik RJ11, | copë | 17.00 | 513.00 | 8,721.00 |
| 3 | An | F.V Kabell rrjeti kompjuterik FTP cat.6 | ml | 200.00 | 160.00 | 32,000.00 |
| 4 | 2.487/a | F.V Kuti, suporte, kapak per celsa priza 3M | copë | 1.00 | 277.22 | 277.22 |
| 5 | 2.487/f | F.V Kuti,suporte,kapak per kanaline 3M | copë | 16.00 | 390.00 | 6,240.00 |
| 6 | An | F.V Tapa fallco 1 Modul | copë | 16.00 | 63.25 | 1,011.93 |
| 7 | An | F.V Kuti shperndarese brenda murit PT-4 | copë | 1.00 | 158.00 | 158.00 |
| 8 | An | F.V Kuti shperndarese jashte murit PT-5 | copë | 2.00 | 305.00 | 610.00 |
| 9 | An | F.V Kanaline plastike e bardhe 100x60 mm | ml | 25.00 | 792.00 | 19,800.00 |
| 10 | 480/2 | F.V Tub plastik fleksibel d=20 | ml | 30.00 | 120.42 | 3,612.67 |
| | | | | | **Shuma VI** | **84,738.83** |
| | | | | | **SHUMA I+II+III+IV+V+VI** | **1,466,383.37** |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | **SHËNIM:** | | | | |
| | | Çmimet e mësipërme të preventivit janë bazuar tek Manualet sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015 | | | | |
| | | si dhe tek çmimet e dala nga testimi i tregut . | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |

**PREVENTIV**

**OBJEKTI : RIKONSTRUKSION I SHKOLLËS 9 - VJEÇARE DOVOLAN**

**EMËRTIMI : INSTALIMET ELEKTRIKE**

**C. PUNIME ELEKTRIKE**

| Nr | Shenja e manualit | Emërtimi i materialit | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlefta |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **VLERA E PAISJEVE ME TVSH** | | | | |
| | | **I.PAISJET E NDRICIMIT** | | | | |
| 1 | 2.A-127 | Ndricues luminishent FL 2x36W,IP40,grile me reflektim pasqyre | copë | 96.00 | 2,654.00 | 254,784.00 |
| 2 | | Ndricues prozhektor LED 60 W, IP65 | copë | 4.00 | 7,440.00 | 29,760.00 |
| | | | | | **SHUMA I** | **284,544.00** |
| | | **II.PAISJET E NDRICIMIT TE EMERGJENCES** | | | | |
| 1 | 2. a-139 | Ndricues fluoreshent emergjence 1x8W,IP20,T=2ore | copë | 12.00 | 4,409.00 | 52,908.00 |
| 2 | | Ndricues fluoreshent evakuimi 1x8W,IP20,T=2ore | copë | 3.00 | 1,100.00 | 3,300.00 |
| | | | | | **SHUMA II** | **56,208.00** |
| | | **III.PAISJET E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE INTERNETIT** | | | | |
| 1 | | Central alarmi I analog 1 zonal,230V,24 ore autonomi | copë | 1.00 | 45,000.00 | 45,000.00 |
| 2 | | Detektore optik termik jonik | copë | 19.00 | 4,500.00 | 85,500.00 |
| 3 | | Baza per sensore | copë | 19.00 | 672.00 | 12,768.00 |
| 4 | | Buton me xham te thyeshem | copë | 1.00 | 8,232.00 | 8,232.00 |
| 5 | | Sirene alarmi e brendshme | copë | 1.00 | 6,400.00 | 6,400.00 |
| 6 | | Sirene alarmi e jashtme | copë | 1.00 | 7,300.00 | 7,300.00 |
| 7 | | Bateri 12 V | copë | 2.00 | 2,100.00 | 4,200.00 |
| 8 | | Switch 24 porta 10/100/1000 | copë | 1.00 | 18,000.00 | 18,000.00 |
| | | | | | **Shuma III** | **187,400.00** |
| | | | | | **SHUMA I+II+III** | **528,152.00** |

**SHËNIM:**

Ky preventiv perfshin çmimet e materialeve me T.V.SH që ndodhen sot ne treg.

## SHËNIME TEKNIKE

Jepet për zbatim projekti për sistemin e drenazhimit perimetral të objektit, Shkolla 9-vjecare ''Dovolan'' për mbrojtjen e godinës nga lagështia nëntokësore.

Drenazhimi do të realizohet me tuba të brinjëzuar drenazhi Dn 200mm me vrima, të cilët lidhen me njëri-tjetrin me puseta 50x50 dhe 80x80 me kapak gize. Vrimat e tubit të drenazhit të jenë në gjerësinë 5mm dhe duhet të jenë vetëm në gjysmën e sipërme të seksionit të tij. Tubi i drenazhit do të mbështillet me gjeotekstil GE DREN 200 gr/m², në mënyrë që tubacioni të mos bllokohet nga papastertitë. Përjashtim bën segmenti D3-Derdhje në kanal dhe segmenti D7- Derdhje në kanal, ujërat e të cilëve kalojnë në tub të brinjëzuar 315mm.
Përvec kësaj, do të bëhet një kanal ekran me zgarë metalike, 25x25 cm, M 100, i specifikuar në vizatimet përkatëse, i cili do të mbledhë ujërat sipërfaqësore të sheshit dhe ujërat që kullojnë nga çatia. Ai fillon në pusetën D1 dhe derdhja e tij do të bëhet në pusetën D7.

Në vizatime janë dhënë në mënyrë të hollësishme, referuar si kuotë ±0.00, kuotës aktuale të dyshemesë së godinës:
-kuotat e kokave të pusetave
-kuotat e fundeve të pusetave
-thellësitë e pusetave
-kuotat në hyrje dhe në dalje të tubave nga pusetat.

Në cdo fazë të zbatimit të respektohen Kushtet Teknike të Zbatimit.
Për çdo paqartësi të konsultohet me projektuesit.

## TABELA E PËRGJITHSHME E MATERIALEVE PËR DRENAZHIMIN E JASHTËM

| Nr. | Emërtimi i materialit | Karakteristika | Njësia | Sasia | Pesha në kg | | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Njësia | Sasia | |
| 1 | Gërmim kanalesh në tokë të fortë me krah | | m³ | 150 | | | |
| 2 | Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah | | m³ | 44 | | | |
| 3 | Transport materiale ndertimi, dheu me auto | | m³ | 106 | | | |
| 4 | F.V tub i brinjëzuar | Dn 200mm, drenazhi | ml | 133 | | | SN4 prEN 13476-1 |
| 5 | Gjeotekstil | GE DREN 200 gr/m² | m² | 84 | | | |
| 6 | Çakëll | 5 - 10 cm | m³ | 64 | | | |
| 7 | Pusetë drenazhi 80x80x100 | | copë | 3 | | | me kornizë e kapak gize |
| 8 | Pusetë drenazhi 50x50x100 | | copë | 2 | | | me kornizë e kapak gize |
| 9 | Pusetë drenazhi 80x80x150 | | copë | 2 | | | me kornizë e kapak gize |
| 10 | Çakëll | 3.2cm | m³ | 35 | | | |
| 11 | F.V tub i brinjëzuar | Dn 315mm | ml | 29 | | | SN4 prEN 13476-1 |
| 12 | Shtresë rërë rreth tubit | | m³ | 7 | | | |

## TABELA E FLETËVE TË PROJEKTIT

| NR. | EMËRTIMI I FLETËS | Nr. i Fletës |
|---|---|---|
| 1 | Shënime teknike të drenazhimit, tabela e fletëve, tabela e materialeve të drenazhimit | HT-00 |
| 2 | Planimetri përgjithshme e drenazhimit | HT-01 |
| 3 | Pusetat D3,D2,D6, Prerje | HT-02 |
| 4 | Prerje kanal drenazhi A-A, Prerje kanal drenazhi B-B,Tabela e materialeve të zgarës metalike | HT-03 |
| 5 | Planimetria e furnizimit me ujë | HT-04 |
| 6 | Planimetria e shkarkimeve të ujërave të zeza | HT-05 |
| 7 | Shënime teknike të F.U dhe Shkarkimeve, Tabela e materialeve të F.U dhe Shkarkimeve | HT-06 |

| RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLËS "DOVOLAN" | PROJEKTI HIDROTEKNIK | HT - 01 |
|---|---|---|

## PLANIMETRIA E PËRGJITHSHME E DRENAZHIT SH 1:150



# RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLËS "DOVOLAN" | PROJEKTI HIDROTEKNIK | HT - 02

PUSETAT D2,D6
SH.1:25




PRERJA 1 - 1
SH.1:25




PRERJA 2 - 2
SH.1:25




PUSETAT D3
SH.1:25




PRERJA 1 - 1
SH.1:25




PRERJA 2 - 2
SH.1:25



PRERJA B - B
SH.1:25




PRERJA A - A
SH.1:25




SEKSION TËRTHOR TIP
SH.1:25




TABELA E MATERIALEVE PER KANALIN ME EKRAN DHE ZGAREN METALIKE

| Nr. | Emertimi i materialit | Karakteristika | Njesia | Sasia | Pesha ne kg | | Shenime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Njesia | Sasia | |
| 1 | Kanali ekran | (25x25) cm | m³ | 6 | | | Beton C 7/10 |
| 2 | Profil "L" 50x50x4mm | | ml | 116 | 3.054 | 355 | |
| 3 | Profil "L" 45x45x4mm | | ml | 116 | 2.733 | 317 | |
| 4 | Hekur i vijaskuar | Ø20mm | ml | 430 | 2.47 | 1062 | |

SHËNIME TEKNIKE:
Kanali me zgarë metalike të realizohet me beton C 7/10, i përmasuar sipas prerjes përkatëse.
Hekuri i vijaskuar Ø 20mm vendoset cdo 5cm. Pëdoren profile "L" 45x45x5 dhe "L" 50x50x5mm.
Hekuri i përdorur për zgarën metalike përfshihet në preventiv në zërin " Konstruksione të thjeshta metalike"

| RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLËS "DOVOLAN" | PROJEKTI HIDROTEKNIK | HT - 04 |
| --- | --- | --- |

Planimetria e Furnizimit me Ujë SH 1:40



## Planimetria e Shkarkimit të Ujërave të Zeza SH 1:40



## SHËNIME TEKNIKE

• Kuotat e furnizimit të pajisjeve hidrosanitare
1. Wc alla turke +1.40m
2. Wc alla frënga +0.7m
2. Lavaman inkaso +0.7m
3. Pisuari +1.35m
4. Boiler + 0.5m

Kuotat e furnizimit me ujë të shkarkimeve tregojnë distancën nga dyshemeja e mbaruar deri te aksi i tubit.

• Kuotat e shkarkimit të pajisjeve hidrosanitare
1.Wc alla frënga +0.35m
2.Lavaman +0.6m
3.Pisuar +0.8m

Furnizimi me ujë do të bëhet nga pusi, që gjendet përpara shkollës. Do të përdoret një pompë me Qmax= 130 l/min dhe Hmax=30m. Më pas ai kalon në një hidroboks 500 l.

Linjat e furnizimit me ujë të pajisjeve hidrosanitare përgatiten prej tubi PPR, ndërsa linja e furnizimit me ujë deri në hyrje të godines të jetë prej tubi PE. Linja PE do të termoizolohet me armofleks.

Në linjën kryesore të furnizimit me ujë, në hyrje dhe në dalje të hidroboksit si dhe në hyrje të cdo degëzimi janë vendosur saracineska sipas diametrave të linjave përkatëse, të cilat bllokojnë furnizimin në rast avarie.

Lavamanët për larjen e duarve në tualetet janë inkaso. Në cdo tualet janë vendosur rubineta ½" në lartësinë 60 cm nga dyshemeja. Një tualet është parashikuar për njerëz me aftesi të kufizuara, në të cilin vendosen pajisjet specifike për ta.

Sistemi i shkarkimeve përbehet nga linjat e shkarkimit prej tubash gri me gominë, piletave dhe pusetës së re prej betoni 80x80, e cila lidhet me rrjetin ekzistues të kanalizimeve ekzistuese.

Pjerrësia e tubacioneve të shkarkimeve të jashtme të jetë në kuotën -0.8 metër, (kuota e sipërme e tubit si dhe të jete paralel me terrenin) i=0.15.

Pjerrësitë e tubacioneve të shkarkimit brenda objektit në drejtim të rrjedhjes jo më të vogla se 3%, kurse jashtë objektit jo më pak se 1%.

Për të siguruar pjerrësinë e shtrimit të tubacionit, kanali të shtrohet me 10 cm beton të varfër C 7/10.

Pas montimit të tubacioneve të furnizimit me ujë, sistemit ti bëhet prova për 24 orë nën presion 1.5 të presionit të punës, kurse sistemit të shkarkimit ti bëhet prova në rrjedhje duke siguruar hermeticitet të plotë.

Të gjitha punimet të bëhen sipas KTZ dhe materialet të jenë sipas standarteve të KE-së.

Projekti të zbatohet sipas kushteve teknike të zbatimit .

## TABELA E MATERIALEVE TË TUALETEVE

| Nr. | Emërtimi | Karakteristika | Njësia | Sasia | Pesha në kg | | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Njësia | Sasia | |
| 1 | WC alla turka | | copë | 6 | | | Porcelani,e kompletuar me kasetën e shkarkimit porcelani |
| 2 | Pisuar | | copë | 3 | | | Porcelani i kompletuar |
| 3 | Lavamanë importi porcelani inkaso me mishelator | | copë | 5 | | | I kompletuar me tuba flesibël dhe minisaracineska |
| 4 | Lavaman importi per njerez me nevoja specifike | | copë | 1 | | | I kompletuar me tuba flesibël dhe minisaracineska |
| 5 | WC alla frenga dhe aksesore per persona me aftesi te kufizuara | | copë | 1 | | | Porcelani,e kompletuar me kasetën e shkarkimit porcelani |
| 6 | Krah mbajtës për persona me aftësi të kufizuar | | copë | 1 | | | I lëvizshëm, në formë U, 70cm, Ø 32 |
| 7 | Kit sanitar me valvul | | copë | 1 | | | I kompletuar |
| 8 | Boiler 12 l | | copë | 2 | | | |
| 9 | Saracineskë bronxi d 32mm | | copë | 3 | | | |
| 10 | Saracineskë bronxi d25mm | | copë | 2 | | | |
| 11 | Saracineskë bronxi d 20mm | | copë | 1 | | | |
| 12 | Tub flesibël 1/2", L=500mm | | copë | 13 | | | I llogaritur për kasetën e WC dhe boileret, me veshje inoksi |
| 13 | Filtër saracineske | | copë | 13 | | | I llogaritur për kasetën e WC dhe boileret, me veshje inoksi |
| 14 | Termoizolim tubi Ø32 me armofleks | | ml | 13 | | | Alumini |
| 15 | Piletë dyshemeje d 50 | | copë | 1 | | | Me kondravalvol |
| 16 | Tub pvc d 50mm | | ml | 17 | 0.43 | 7.31 | Për shkarkimet e ujërave të zeza |
| 17 | Tub pvc d 110mm | | ml | 11 | 1.59 | 17.49 | Për shkarkimet e ujërave të zeza |
| 18 | Tub pvc d 140mm | | ml | 10 | 2.5 | 25 | Për shkarkimet e ujërave të zeza |
| 19 | Pjesë speciale PVC | | kg | 7 | 14% | | |
| 20 | Boiler 80 l | | copë | 1 | | | |
| 21 | Tuba dhe rakorderi ujësjellësi PPR d 20mm, Pn 16 | | ml | 37 | | | Për furnizim me ujë |
| 22 | Tuba dhe rakorderi ujësjellësi PPR d 25mm, Pn 16 | | ml | 6 | | | Për furnizim me ujë |
| 23 | Tuba dhe rakorderi ujësjellësi PPR d 32mm, Pn 16 | | ml | 13 | | | Për furnizim me ujë |
| 24 | Tuba dhe rakorderi ujësjellësi PE d 32mm, Pn 10 | | ml | 80 | | | Për furnizim me ujë |
| 25 | Tub xingato dhe rakorderi d 32mm | | ml | 3 | 3.26 | 9.78 | Për furnizim me ujë |
| 26 | Rubinetë | | copë | 6 | | | Alumini, ½" |
| 27 | Valvol moskthimi | | copë | 2 | | | |
| 28 | Presostat | | cope | 1 | | | |
| 29 | Pompë uji | Zhytëse, Q= 130 l/min H=30 m | copë | 1 | | | |
| 30 | Hidroboks 500 l | | copë | 1 | | | |
| 31 | Beton C 7/10 | | m³ | 0.5 | | | Për kanalin e shkarkimit |
| 32 | Pusetë betoni | | cope | 1 | | | 80x80x100 |
| 33 | Hapje vrimash në themel | | m³ | 2 | | | |
| 34 | Gërmim dheu | | copë | 3 | | | |
| 35 | Aksesor tualeti | Pasqyrë | copë | 3 | | | |
| 36 | Shufër mbajtëse për persona me aftësi të kufizuar | | copë | 1 | | | Fikse, Ø 32 mm |
| 37 | Zhavorr | | m³ | 2.1 | | | Për kanalin e tubit Dn 315mm |

MIRATOI:
KRYETARI I BASHKISE DIBER
MUHAREM RAMA

**PREVENTIV**

**OBJEKTI : RIKONSTRUKSION I SHKOLLËS 9 - VJEÇARE DOVOLAN**
**EMËRTIMI : RIKONSTRUKSION**

**A. PUNIME NDËRTIMI**

| Nr | Shenja e manualit | Emërtimi i materialit | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlefta |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **I.PUNIME DHEU** | | | | |
| 1 | 2.1 | Germim dheu me krah e transport me k dore 10 m | m3 | 15.00 | 637.00 | 9,555.00 |
| 2 | 2.5 | Gërmim e mbushje dheu me krah për themele, h = 1.5m | m3 | 18.00 | 714.00 | 12,852.00 |
| 3 | 2.37/5b | Transport mbeturinash me auto deri në 10km | m3 | 178.00 | 467.00 | 83,126.00 |
| | | | | | **Shuma I** | **105,533.00** |
| | | **II.PUNIME MURATURE** | | | | |
| 1 | 2.65/2 | Mur me tulle të plota t=30cm llaç përzier M 25 | m3 | 3.00 | 18,891.00 | 56,673.00 |
| 2 | 2.71/2 | Mur me tulla të lehtësuara t=25cm me ll. p.M25 | m3 | 13.00 | 10,401.00 | 135,213.00 |
| 3 | 2.70/2 | Mur me tulla të lehtësuara t=12cm me ll.p.M25 | m3 | 5.00 | 12,617.00 | 63,085.00 |
| 4 | 2.108/3 | Ndërtim muri me knauf t=10cm me dy shtresa, kundër lagështirës | m2 | 29.00 | 3,644.00 | 105,676.00 |
| | | | | | **Shuma II** | **360,647.00** |
| | | **III.PUNIME BETONI E BETONARME** | | | | |
| 1 | 2.109/2 | Themel betoni C12/15 për muret e rinj | m3 | 14.00 | 8,545.00 | 119,630.00 |
| 2 | 2.114/1 | Brez b/a në themel C - 16/20 | m3 | 2.00 | 8,398.00 | 16,796.00 |
| 3 | 2.119/1 | Arkitrarë b/a C16/20 | m3 | 1.40 | 15,974.00 | 22,363.60 |
| 4 | 2.119/1a | Trarë b/a C20/25 | m3 | 4.00 | 14,964.00 | 59,856.00 |
| 5 | 2.121/1 | Brez b/a C 16/20 antisizmik | m3 | 3.00 | 12,420.00 | 37,260.00 |
| 6 | 2.117/1a | Kollona b/a monolite C 20/25 | m3 | 3.00 | 17,279.00 | 51,837.00 |
| | | | | | **Shuma III** | **307,742.60** |
| | | **IV.PUNIME HEKUR BETONI** | | | | |
| 1 | 2.166 | F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm | kg | 365.00 | 113.16 | 41,302.31 |
| 2 | 2.167 | F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm | kg | 1,475.00 | 103.50 | 152,659.55 |
| | | | | | **Shuma IV** | **193,961.86** |
| | | **V.PUNIME H/IZOLIMI** | | | | |
| 1 | 2.218 | Çati vendi zakonshme HD~8m, mbuluar me tjegulla vendi | m2 | 197.00 | 4,374.00 | 861,678.00 |
| 2 | 2.209/a | Ulluk shkarkimi vertikal me PVC Ø 120mm | ml | 12.00 | 351.00 | 4,212.00 |
| 3 | 2.212/a | Ulluk shkarkimi horizontal me PVC 33cm | ml | 129.00 | 446.00 | 57,534.00 |
| 4 | An | Riparim çatia ekzistuese (strukturë druri) | m3 | 5.00 | 36,893.00 | 184,465.00 |
| | | | | | **Shuma V** | **1,107,889.00** |
| | | **VI.PUNIME SHTRESASH** | | | | |
| 1 | 2.258 | Shtresë zhavorri 10cm nën themele | m3 | 2.00 | 1,355.00 | 2,710.00 |
| 2 | 2.258 | Shtresë zhavorri 20cm në dysheme | m3 | 10.00 | 1,355.00 | 13,550.00 |
| 3 | 2.262/1 | Shtrese betoni C 7/10 t=10cm në dysheme | m3 | 5.00 | 7,994.00 | 39,970.00 |
| 4 | 2.264 | Shtresë llustër çimento 1:2 në dysheme t=2cm | m2 | 606.00 | 332.00 | 201,192.00 |
| 5 | 2.196/c | Hidroizolim me dy shtresa mapej +30cm në mure dhe në WC +100cm | m2 | 784.00 | 1,368.00 | 1,072,512.00 |
| 6 | 2.267/1 | Shtresë me pllaka grez importi cil I-rë + plintusat | m2 | 654.00 | 2,753.00 | 1,800,462.00 |
| 7 | 3.620 | Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka | m2 | 122.00 | 1,305.00 | 159,210.00 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | 3.616 | F V bordura betoni 12x25 cm | ml | 136.00 | 622.00 | 84,592.00 |
| | | | | | **Shuma VI** | **3,371,488.00** |
| | | **VII.PUNIME SUVATIMI E TAVANI** | | | | |
| 1 | 2.310 | Suvatim muri i brendshëm me krah,ll.p.M 25(100%) | m2 | 1,293.00 | 674.00 | 871,482.00 |
| 2 | 2.328 | Patinim muri me knauf | m2 | 58.00 | 248.00 | 14,384.00 |
| 3 | 2.314 | Suvatim kollonash h~4m me krah me ll. P. M 25 | m2 | 15.00 | 1,022.00 | 15,330.00 |
| 5 | 2.334 | Suvatim i zakonshëm fasade + xokoli (100%) | m2 | 422.00 | 1,056.00 | 445,632.00 |
| 6 | 2.330 | Patinim tavani me knauf | m2 | 635.00 | 387.00 | 245,745.00 |
| 7 | An | Tavan me dopjo kartonxhes + lesh guri t=5cm në mes | m2 | 635.00 | 4,383.00 | 2,783,205.00 |
| 8 | 2.326 | Veshje WC me pllaka majolike h=2.1m | m2 | 111.00 | 2,133.00 | 236,763.00 |
| | | | | | **Shuma VII** | **4,612,541.00** |
| | | **VIII.PUNIME DYER DRITARE** | | | | |
| 1 | 2.375/a | F.V. dritare d/alumini dopjo xham. | m2 | 71.20 | 10,951.00 | 779,711.20 |
| 2 | 2.388 | F.V. dyer druri zemër dërrase,kasë dërrase,1/2 xham | m2 | 31.00 | 10,208.00 | 316,448.00 |
| 3 | 2.386/2 | F.V. dyer të blinduara importi. | m2 | 4.00 | 42,990.00 | 171,960.00 |
| 4 | 2.395/a | F.V.derë d/alumini pa xham,me mbushje d/a. | m2 | 9.00 | 10,999.00 | 98,991.00 |
| | | | | | **Shuma VIII** | **1,367,110.20** |
| | | **IX.PUNIME BOJATISJE** | | | | |
| 1 | 2.404 | Lyerje muresh dhe tavanesh me bojë hidroplastike | m2 | 1,875.00 | 174.00 | 326,250.00 |
| 2 | 2.404 | Lyerje fasade + xokol me bojë hidroplastike | m2 | 422.00 | 174.00 | 73,428.00 |
| | | | | | **Shuma IX** | **399,678.00** |
| | | **X.PUNIME TË NDRYSHME DHE PRISHJE** | | | | |
| 1 | 2.426 | Prishje mur tulle pa pastrim | m3 | 33.00 | 626.00 | 20,658.00 |
| 2 | 2.426/7 | Prishje kollonash b/a ekzistuese | m3 | 2.00 | 6,356.00 | 12,712.00 |
| 3 | An | Prishje suvatim muri i brendshëm ekzistues | m2 | 1,184.00 | 160.00 | 189,440.00 |
| 4 | An | Prishje suvatim muri i jashtëm + xokoli ekzistues | m2 | 396.00 | 225.00 | 89,100.00 |
| 5 | An | Prishje çatie ekzistuese | m2 | 168.00 | 279.00 | 46,872.00 |
| 6 | An | Heqje pllaka dyshemeje ekzistuese | m2 | 583.00 | 171.00 | 99,693.00 |
| 8 | An | Heqje shtrese llustër çimento dyshemeje | m2 | 583.00 | 68.00 | 39,644.00 |
| 9 | An | Heqje dritare ekzistuese | m2 | 71.00 | 201.00 | 14,271.00 |
| 10 | An | Heqje dyer ekzistues | m2 | 35.00 | 207.00 | 7,245.00 |
| 11 | An | Heqje davanciale dritaresh | m2 | 17.00 | 253.00 | 4,301.00 |
| 12 | An | Heqje pllakash majolike | m2 | 53.00 | 382.00 | 20,246.00 |
| 13 | An | Heqje tavani me kallama + suva | m2 | 583.00 | 723.00 | 421,509.00 |
| 14 | An | F.V.davanciale mermeri | m2 | 18.00 | 4,896.00 | 88,128.00 |
| | | | | | **Shuma X** | **1,053,819.00** |
| | | | | | | |
| | | | | **SHUMA TOTALE (I - X)** | | **12,880,409.66** |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | **SHËNIM:** | | | | |
| | | Çmimet e mësipërme të preventivit janë bazuar tek Manuali 2 dhe 3 sipas VKM nr.629 | | | | |
| | | datë 15.09.2015 si dhe tek çmimet e dala nga testimi i tregut . | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |

| | |
|---|---|
| | |